

# Dukagjini "Nderi i Kombit"



# Dukagjini

**Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XIX i botimit, nr. 230, Dhjetor 2022**  
Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: [www.shoqatadukagjini.com](http://www.shoqatadukagjini.com), Kryeredaktore: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

## Gëzuar Kërshëndellat

### Gloria - Krishti ka lindur - Krishti ka lindur

Kjo festë e bekuar përcjell lumturi dhe u jep besimtarëve të krishterëve në mbarë botën gëzimin shpirtëror dhe shpresën për jetën. Ajo ka lindur në dritën e besimit, shpresës dhe dashurisë dhe për shekuj me radhë, na tërheq drejt vlerave të vërteta shpirtërore. Krishtlindja është festa e bekuar dhe përbën një traditë të mirë për të treguar dashurinë për të afërmin, mbështetjen për ata që kanë nevojë, kujdesin ndaj familjes, ndihmesën ndaj të varfrit, mirënjohjen e sinqertë për njeriun e përkushtuar ndaj punës. Është e rëndësishme që këto vlera njerëzore të trashëgohen nga brezat e rinj, të cilët me veprimtarinë e tyre do t'i sjellin vendit begati dhe një të ardhme të suksesshme. Është e rëndësishme që këto vlera të dominojnë sidomos sot, kur një pjesë e popullsisë po përjeton momente të vështira për të dëshmuar edhe një herë se në të mirë e në të keq, ne shqiptarët jemi përkrah njëri-tjetrit pa asnjë dallim. Krishti tashmë i mishëruar në Betlehem ardhte tek ne e sjelltë Paqen, Shpresën dhe Dashurin! Gëzuar Kërshëndellat!



# REALIZIMET E VITIT 2022, PAVARËSISHT PROBLEMEVE TË VITIT, MENDOJMË SE DO TË JENË NJË BAZË NISJE E MIRË, PËR TË VIJUAR REALIZIMIN E MISIONIT TË SHOQATËS, PËR VITIN 2023

Anëtar të shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, dukagjinat dhe simpatizantë të tyre, Dita e lindjes së Jezuesit po vjen dhe ardhë e bardhe, se me siguri do të lind një ditë e re për ne dukagjinat e gjithë shqiptaret kudo janë.

Të dashur, viti 2022 po mbyllet, edhe pak ditë janë, i cili jo me pak probleme po mbyllet, se për efekt të natyrës, shirave të shumta, që ranë na çuan deri në varrimin e dy vetëve, babe e bir, Pjeter Rushaj, me djalin Jasonin, që fatkeqësisht ju mori jetën përroi i Thatë.

Megjithatë, në këto kushte ende të Pandemisë e të fatkeqësive natyror, kemi përgatitur e zhvilluar disa veprimtari, por dhe kemi marre pjese në veprimtari të ndryshme.

Ato janë:

**Së pari**, botimi gazetës “Dukagjini” ka vijuar të botohet në çdo muaj, në saj të punës së palodhur të redaksisë së gazetës me në krye Luigj Shyti dhe i dashamirësve të saj, që nuk janë pak. Në këtë muaj, del numri 230 i saj. Për botimin e saj, është dhe kontributi i pakursyer të dukagjinave kudo ndodhur, Niko Marku nga Nicajt e Shalës, nr. 219; Anton Kosteri-Sekretari i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, nr. 2020; Ermal Shytani nga Nenmavriq, me banim ne Angli, nr. 221; Gjergj Demaj nga fshati Sume, biznesmen ne Grille, nr. 222; Tonin Mani nga fshati Kir, emigrant ne Krete, nr. 223; Dede Prendaj nga fshati Nenmavriq- Shale, me banim ne Miçigan, nr. 224; av Sokol Dedndreaj nga fshati Salce, Merturi, me banim ne Tirane, nr. 225; Petrit Sokoli nga fshati Lekaj-Shale, me banim ne Miçigan, nr. 226; Lazer Kulla nga fshati Ndreaj Shosh, me banim ne Kanada, nr. 227 e 228 dhe Agron Hasanaj N/kryetari i Shoqatës, nr. 230. Për botimin e 12 numrave te gazetës janë konsumuar gjithsej 246 000 leke,, të cilët i falënderojmë dhe i urojmë, me urimin popullor “Paçi e dhënçi!”

**Së dyti**, me datën 20 janar 2022, ditë e Enjte, në mjediset e Bashkisë Shkodër, nga Presidenti i Republikës, z. Ilir Meta, me propozim të Kryesisë së Shoqatës, dekorohet kantautori Mhill Çun Gjonaj, me urdhrin “Mjeshtër i Madh”.

Po në këtë date e dite, në ora 18. 00, në teatrin “Migjeni”, u zhvillua ceremonia e Natës Finale e personaliteteve të vitit 2021 për Shkodrën. Një organizim i shkëlqyer nga Presidenti i spektakleve “Buna 1”, nga zoti Arben Mazi. Kjo veprimtari prezantuese e votuese ka filluar me datën 10 dhjetor 2021 deri me datën 10 janar 2022, për personalitete në tetë fusha të ndryshme: mësuesi më i mirë; humoristi më i mirë; këngëtar më i mirë; sportisti më i mirë; piktori më i mirë; politikani më i mirë; shkrimtari më i mirë dhe trajneri më i mirë.

Prele Milani shpallet shkrimtari më i mirë, për vitin 2021.

**Së treti**, me datën 13 mars 2022, në mjedisin e shkollës “Edith Durham”, në bashkëpunim me shkollën 9-vjeçare në lagjen “Mark Lula”, në Bardhaj, në Hot

të Ri, në Grudë të Re, në Vrakë; “Martin Camaj” në Shkodër; “Zemra e Krishtit” dhe “Dëshmoret e Prishtinës”, në shkollat e njësisë Administrative Shalë, Shosh e Pult, apo ndonjë tjetër shkollë të veçantë, organizuam takimin me nxënës të klasës IX ekselent, me teme: “Shkollimi e edukimi janë çelësi i emancipimit të shoqërisë sonë”, me qëllimin kryesor, që nëpërmjet këtij takimi, të japim mesazhin apo të tërheqim vëmendjen, se vetëm shkollimi të emancipon e të hap rrugën të ecim përpara në jetë”.

Kryesia e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, me vendim nr. 266, date 15 shkurt 2022 vendosi: Të krijohet simboli i nderimit “Mirënjohja mësuese Kushë Micja”, me të cilën do të nderohen mësuesit, nxënësit e studentet dhe ky titull jepet me vendim të veçantë të kryesisë së Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”.

### Kush është Kushë Micja?

Për këtë figure kanë studiuar e shkruar plote personalitete të fushës së shkollimit dhe në mes tyre Hamdi Bushati, Simon Rrota, Njazi Kazazi, Gjush Sheldia, Ludovik Shllaku, gazeta e Diaspores e të tjerë e të tjerë dhe të gjithë janë në një mendim, se Kushë Micja ishte e para femër, që hapi shkollën femërore në vitin 1859. Informacione më të detajuara mbi veprimtarinë e saj në veprimtari u dhanë nga studiuesi, botuesi e publicisti, Kryeredaktori i gazetës “Dukagjini”, zoti Luigj Shyti, qe ne mes te tjerave theksoi: “Kushë Mica, themeluesja e shkollës së parë për gratë e vajzat shqiptare. Më 16 qershor 1832 në Shkodër, lindi Kushë Mica, themeluesja e shkollës së parë për gratë dhe vajzat shqiptare. Familja e saj, për arsye konflikti gjakmarrjeje, u zhvendosën në Shkodër nga Dukagjini. Filloi të jepte mësim në moshën 27-vjeçar. Një grua e vetë mësuar, për dhjetë vjet studioi me farmacistin Venecian Shjor Marko Rebeskin dhe u thellua në gjuhët frënge dhe italiane. Në vitin 1859, hapi shkollën e parë për gra në Shkodër, të quajtur “Shkolla e Kushë Micës”, ku jepej shkrim, lexim, numra (aritmetike), vizatim, këngë (muzikë) dhe punë dore. Shkolla u mbyll në vitin 1904, 45 vite pas themelimit të saj.

Gjatë veprimtarisë u vlerësuan 31 nxënës të ekselencës të klasave të nënta të disa prej shkollave 9-vjeçare të qarkut Shkodër:

\*Shkolla 9 vjeçare Gimaj:

1) Xhesika Lulash Zelna, lindur me 25 qershor 2006, në fshatin Gimaj, e bija e Lulashit dhe e Afërditës.

2) Emanuel Rrok Ndou, lindur me 13 tetor 2006, në fshatin Gimaj, i biri i Rrokut e Mirës.

Shkolla 9 vjeçare “Mehmet Shpendi”:

1) Valter Kole Pali, lindur me 17 korrik

2007, në fshatin Lekaj, krahina e Shalës, i biri i Kolës e Tones. 2) Sidorela Gjovalin Sheja, lindur me 7 shtator 2006, në fshatin Abat, krahina e Shalës, e bija e Gjovalinit e Verës.

\*Shkolla 9 vjeçare Theth:

1) Marinela Gjovalin Lokthi, lindur me 4 maj 2007, në fshatin Theth, e bija e Gjovalinit e Manjoles. 2) Kristjana Lulash Vali, lindur me 10 mars 2008, në fshatin Theth, e bija e Lulashit e Tones.



\*Shkollat 9 vjeçare Pult-Shosh:

1) Sindi Sokol Serraj, datëlindja 10 dhjetor 2006, i biri i Sokol e Mare Serraj, klasa IX,

\*Shkolla 9 vjeçare në fshatin Plan, njësi administrative Pult.

2) Ardita Lazer Brija, datëlindjes 23 shtator 2007, e bija e Lazerit e Tringes, klasa e IX,

(Shkolla 9 vjeçare në fshatin Xhan, njësi



si administrative Pult.

3) Klevis Pjeter Çorri, i datëlindjes 21 janar 2007, i biri i Pjeter e Zoje Çorri, shkolla 9 vjeçare në fshatin Palaj, njësi administrative Shosh.

\*Shkolla 9-vjeçare “Dede Gjon Luli”, në Hot të Ri:

1) Armela Gjergj Kola, lindur me 17 gusht 2008, e bija e Gjergjit e Manjoles, në fshatin Bene, krahina e Shllakut dhe banuese në Hot të Ri. Nxënëse ekselence në përparim dhe një nxënëse model në paraqitjen e saj në shkollë.

2) Melisa Paulin Mirashi, lindur me 21 korrik 2008, e bija Paulinit e Meritës, lindur në Prekal dhe banuese në Hot të Ri, Presidente e qeverisë së nxënësve e zgjed-

hur me votat e nxënësve për vitin shkollor 2021-2022, një nxënëse e shkëlqyer në mësim, në interpretim dhe pjesëtarë e grupit të valleve të shkollës. me motivacion: “Për rezultate të larta në procesin mësimor dhe edukativ; për një angazhim të lartë në përvetësimin e dijeve shkencore dhe në marrjen pjesë aktive në veprimtaritë jashtëshkollore”

\*Shkolla 9- vjeçare “Vasil Shanto” Vrake:

1) Kristjana Plepi, me origjinë nga Plani dhe me banim në Vrakë, me mesatare 10 dhe me një sjellje shembullore, pjesë e ekipit të futbollit të vajzave, që po përfaqësojnë me shumë dinjitet Malësinë e Madhe,

2) Majlinda Molla me origjinë nga fshati Theth e banuese në Vrake, me notë mesatare 10, me sjellje shembullore, me motivacion: “Nxënëse e shkëlqyer në mësim dhe më një sjellje shembullore, e pranishme në të gjitha veprimtaritë sensibilizuese të shkollës”.

\*Shkolla 9 vjeçare Bardhaj:

1) Elizabeta Tomë Martini, lindur me 6 korrik 2007 në Shkodër, me origjinë nga fshati Nicaj, krahinë e Shalës, e bija e Tomes e Bardhës.

2) Gentjana Dedë Shkrepa, lindur me 6 gusht 2007 në Shkodër, me origjinë nga fshati Plan, krahinë e Pultit, e bija e Deds e Valbonës. me motivacion: “Për rezultate të larta në procesin mësimor dhe edukativ; për një angazhim të lartë në përvetësimin e dijeve shkencore dhe në marrjen pjesë aktive në veprimtaritë jashtëshkollore.

\*Shkolla 9-vjeçare”Tring Smaçli”, Grude e Re, drejtor Gjesh Doçaj:

1) Vlison Vitor Ndrecaj, lindur me 1 dhjetor 2006, në Shkodër, me origjinë nga krahina e Shoshit, i biri i Vitorit e Enkelejdës.

2) Rita Pashk Malaj, lindur me 6 gusht 2007, në Shkodër, me origjinë nga krahina e Shalës, e bija Pashkut e Hënës.

3) Simona Pjerin Shegaj, lindur me 19 qershor 2007, në Shkodër, me origjinë nga fshati Plan, krahina e Pultit, e bija e Pjerinit e Verës.

4) Kristina Mirash Shytani, lindur me 31 dhjetor 2006, në Shkodër, me origjinë nga krahina e Shalës, e bija e Mirashit e Gjuljanës.

5) Landa Pal Çermeli, lindur me 12 tetor 2006, në Shkodër, me origjinë nga krahina e Shalës, e bija e Palit e Lenës.

6) Manuela Tonin Ara, lindur me 28 nëntor 2006, në Shkodër, me origjinë nga krahina e Shoshit, e bija e Toninit e Lizës.

\*Shkolla 9-vjeçare “Martin Camaj”:

1) Piter Aurel Delija, i biri i Aurelit e Elvanes, me origjinë nga fshati Pecaj, njësi administrative Shale; 2) Sara Lulash Skollaj, e bija e Lulashit e Nores, me origjinë nga fshati Gimaj, njësi adminis-

trative Shalë

3) Noel Artur Cukeli, i biri i Arturit e Mimozës, me origjinë nga fshati Abat, njësia administrative Shalë.

Shkolla 9-vjecare "Edith Durhami", lagja "Mark Lula"-Shkodër:

1- Leonardo Nikoll Zyla, lindur me 20 tetor 2006, në qytetin Shkodër, i biri i Nikolles e Lezes, me origjinë fshati Toplane, njësia administrative Temal.

2- Angjelin Kujtim Guri, lindur me 25 maj 2007, në qytetin Shkodër, i biri i Kujtimit e Gjystes, me origjinë nga fshati Theth, njësia administrative Shalë.

3- Frederika Fran Proj, lindur me 10 shkurt 2007, në qytetin Shkodër, i biri i Franit e Diloresh, me origjinë nga fshati Gimaj, njësia administrative Shalë.

4- Driot Dede Kodra, lindur me 24 nëntor 2006, në qytetin Shkodër, i biri i Dedës e Luljetës, me origjinë nga fshati Gegaj, njësia administrative Shllak.

5- Desana Fred Ndoci, lindur me 16 nëntor 2006, në qytetin Shkodër, i biri i Fredit e Zines, me origjinë nga fshati Mazrek, njësia administrative Shllak.

\*Shkolla 9-vjecare "Zemra e Krishtit":

1) Donato Mark Bobnaj, lindur në Shkodër, me 14 maj 2007, i Markut e Shores, me origjinë nga fshati Gimaj, krahina e Shalës,

\*Shkolla 9 vjeçare "Dëshmorët e Prishtinës":

1) Reila Pal Pepaj, lindur me 7 tetor 2007, e bija e Palit e Verës, në qytetin Shkodër, me origjinë fshati Kroi i Madh, krahina e Shllakut, me motivacion: "Për përparim të lartë në mësim dhe për sjellje shembullore, e pranishme në të gjitha veprimtaritë sensibilizuese të shkollës.

Me këtë rast u nderuan dhe 7 mësues e mësuese: Vitore Kodra, Drita Zefi, Age Villi, Mimoza Livadhi, Viola Shqau, Arjana Funiçi-Martini, Kujtim Lamthi.

Kjo veprimtari u përgatitë dhe u zhvillua në saj të mundësisë financiare të dukagjinase në banim në Kanada: Sokol Sterbyqi, Preke Gjonaj, Mirash Lallinaj, Luigj Lallinaj, Kristian Qershia, Besnik Arrinaj, Nikolle Gerla, Angjelin Rashkadoli dhe Arben Toma, të cilët i falënderojmë dhe ju urojmë: Paçin e dhëncin!

Në qendër të këtij takimi u shtrua, se shkollimi të emancipon e të hap rrugën e jetës. Të gjithë pjesëmarrësit, nxënësit, mësuesit dhe prindërit e tyre ju shprehim mirënjohjen, që kursyen pak kohe, nga koha e tyre shumë e çmuar, i falënderojmë, që u bënë pjesë e kësaj veprimtarie dhe e gjallëruan atë.

Së katërti, me datën 27 prill 2022, ne takimin: Unioni i gazetarëve shqiptarë, Qarku Shkodër, në edicionin e pestë, -Gazeta "Dukagjini" u nderua me çmimin "Hamit Borici", me motivacionin: "Që prej vitit 2003, kur u botua numri i parë dhe deri më sot kur është në proces numri i 222-të, Gazeta "Dukagjini", është sistematikisht e pranishme për lexuesin shkodran, atë kombëtar dhe mbarëkombëtar, me botim në letër dhe online. 3077 artikuj cilësorë dhe profesional të botuar në vite nga 575 autor, janë një kontribut me shumë vlerë, jo vetëm për promovimin e vlerave të pasura historike dhe turistike të Dukagjinit dhe rajonit verior, por edhe të të gjithë vendit në përgjithësi". Një vlerësim, që ne nxiti e na nxite për te mos u ndaluar në punën tonë për nxjerrjen e gazetës, e cila në këtë muaj del nr. 230 i saj.

Së pesti, me 30 prill 2022, morëm pjesë

në inaugurimin e disa objekteve në Shalë, të kishës në fshatin Gimaj, shtatoren e Shën Ndout në Breg-Lumi dhe të disa urave këmbësore për kalimin e lumit të Shalës, të ndërtuara me kontributin financiar të shoqatës "Emigranti për vendlindjen".

Së gjashti, me datën 21 maj 2022, morëm pjesë në manifestimin "Zëri i Vel-lazerise-2022", të organizuar nga shoqata "Martin Dreshaj", me titull "Ora e Zërit", ku u përfaqësua nga Gjergj Leqejza, Prele Milani, Lualsh Brigja e Angron Hasanaj, dhe Shoqata "Besa Shoshi", me Ndoc Fushën e Gjon Kosterin. Prele e Lulashi u prezantuan me nga një poezi, dhe nga ana tjetër u promovua libri i Luigj Shytit e Zef Sokolit, me titull "Dukagjini-2012". Ky manifestim ju kushtua vetëm letërsisë dhe kryesisht poezisë. Prandaj u quajt "Ora poetike e Zërit".....

Së shtati, me datë 28 Maj 2022, dite e Shtune, u mbajt koncerti recital "Zani i Bjeshkëve", i këngëtarit Pëllumb Vatnikaj, anëtar i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", në ambientet e Art Center "Blue Skay" një sallë gjigande e ideuar për spektakël. Pëllumbi, me këtë rast, për këtë sukses Kryesia e Shoqatës, e nderoi me titullin e lartë "NDERI I SHOQATËS ATDHETARE DUKAGJINI", me motivacion: "Për kontributin tuaj disa vjeçar në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore folklorike të Dukagjinit; për vlerat e larta artistike dhe mesazhin e dashurisë që përcjellin këngët e tua për vendlindjen; për imazhin e shkëlqyer si ambasadori i traditave tona, në vendin ku jetoni".

Së teti, me propozim të Kryesisë së Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Presidenti i Republikës së Shqipërisë, zoti Ilir Meta, me datën 12 korrik 2022, ka dekoruar Dom Prekë Ndrevasen, pas vdekjes me titullin "Kalorësit i urdhrit të Skënderbeut" dhe artisten Rita Ndoci, me urdhrin "Mjeshtër e Madhe".

Së nënti, me datën 2 Korrik nga Bashkia Shkodër, në Theth u zhvillua hapja e Turizmit, në të cilën morëm pjesë së bashku me Prele Milanin dhe bëmë përpjekje të jepnim kontributin tonë në realizimin e saj me sukses,

Së dhjeti, morëm pjesë në përkujtimoren e të rënëve me 15 korrik 1915, në Qeresh. Atje mori pjesë anëtar i kryesisë, Vilson Peshkaj me Gjovalin Kodren, të cilët vunë kurorë dhe përshëndeten në emër të shoqatës; ndërsa po në këtë date nderuam dhe Mehmet Shpendin, duke vu kurorë pranë monumentit të tij.

Së njëmbëdhjeti, Kryesia e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", me mbështetjen e bashkësisë dukagjinase ka vendosur që qytetit Shkodrës ti dhurojë shtatoren (bustin) e Princit Lekë Dukagjini, për ta vendosur në një nga sheshet kryesore të këtij qyteti, me këto përmasa: "Monumenti (Busti) i Princit Lekë Dukagjini, është në mermer, me përmasa 2 m i lartë dhe së bashku me bazamentin e vendosjes të tij, 3 m, i gjithë monumenti shkon 5 m i lartë". Për këtë ju, është propozua: Miratimin e sheshit për vendosjen e monumentit (Bustit) të Princit Lekë Dukagjini: Sheshi

(lulishtja në mes godinës së bashkisë dhe bibliotekës "Marin Barleti", me dokument Nr. 1453 prot. datë 01 / 09 / 2022. Për realizimin e tij, janë bere disa takime me autoritetet vendore.

Së dymbëdhjeti, kryesia e shoqatës në bashkëpunim me miqtë e kantautorit, tani "Mjeshtër i Madh", me rastin e një vjetorit e ndarjes nga jeta, organizoj e zhvilloi një veprimtari përkujtimore.

Së trembëdhjeti, anëtarja e kryesisë Klodjana Serraj, me 12 shtator 2022, në Jordani prezantoi: "virtutin Besën, Mikpritjen dhe Xhubletën, duke përfaqësuar Shqipërinë. Sipas Klodjanës në Jordani: "Udhëtimi im më i fundit në Jordani, është një nga eksperiencat më jetë ndryshuese bërë gjithë këto vite, sepse ashtu vendosa të prezantoj natën kulturore dhe veten, duke treguar rrënjët se përveç



prejardhjes nga Shqipëria edhe zonën ku kam origjinën".

Së katërmëdhjeti, morëm pjesë në festën e Gështenjës, që u organizua nga gazetari Mark Gjeka e biznesmeni Nikolin Shqau, me Prele Milanin, Aleks Dushin, Lulash Brigjen e Meritan Spahine, me makine të Meritanit.

Së pesëmbëdhjeti, me datën 30 dhjetor 2022, do të organizojmë festën e nxjerrjes së numrit të parë të gazetës "Dukagjini",



20 vjetorin e saj.

Këto arritje, në këtë vit nuk janë bere pa shpenzime financiare nga dukagjinasi kudo janë:

Për gazetën i theksova më sipër, gjithsej 246 000 leke nga Niko Marku, Anton Kosteri, Ermal Shytani, Gjergj Demaj, Dede Prendaj, Sokol Dedndreaj, Lazer Kulla, Petrit Sokoli, Lulash Ara e Agron Hasanaj.

Përveç lekeve për gazetën janë dhënë dhe të tjera për nevojat e shoqatës: Luigj Temali-2 000 leke, Pjeter Gera-2 000 leke, Gjergj Leqejza një here 16 000 leke, Aleks Martin-2 000 leke, Preke Gjonaj 100 dollarë, Agron Hasanaj-2000 leke. Gjithsej 35 000 leke. Përveç ndihmesën

që kane dhanë shokët Agim Gila (Martini), Agron Hasanaj, Anton Kosteri, Gjergj Leqejza, Lulash Gjeloshi dhe nga Kanadaja: Shan Staka 200 \$, Sokol Sterbyqi 300 \$, Preke Gjonaj 300 \$, Mirash Ladhinaj 100 \$, Kristian Qershia 100 \$, Luigj Ladhinaj 100 \$, Besnik Marinaj 100 \$, Nikoll Gerla 100 \$, Angjelin Rashkadoli 100 \$ e Arben Toma 50 \$, gjithsej 1 250 \$ = 102 934 leke dhe ndonjë tjetër, duke na lëvizur me automjetin e tyre nga një vend në tjetrin.

Të gjithë i falënderojmë për kontributin e tyre, që kane bërë përpjekje të kursejnë nga pak për Shoqatën e tyre.

Bazuar në arritjet e këtij viti, për vitin 2023, duke u nisur se është 20 vjetori i themelimit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", janë planifikuar këto veprimtari:

1-Vijimin e nxjerrjes së gazetës, në çdo muaj;

2-Në kuadrin e 7-8 marsit 2023 të organizojmë një veprimtari kushtuar nxënësve, studenteve, mësuesve e grave, nënave;

3- Rivendosja e monumentit të albanologut Martin Camaj, brenda datës 12 mars 2023;

4-Festimi i 20 vjetorit të themelimit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", me 13 maj 2023;

5-Vendosja e shtatores së Princit Leke Dukagjini, brenda muajit qershor 2023;

6-Marrja pjesë në veprimtari të shoqatave analoge në hapësirat shqiptare;

7-Përgatitja e zhvillimi i konferencës së VI të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", në muajin shtator 2023.

Për të realizua këto veprimtari, është planifikuar ky fond:

1-Vijimin e nxjerrjes së gazetës në çdo muaj, duhen gjithsej 246 000 leke;

2-Në kuadrin e 7-8 marsit 2023 të organizojmë një veprimtari kushtuar nxënësve, studenteve, mësuesve e grave, nënave, duhen rreth 150 000 leke;

3- Rivendosja e monumentit të albanologut Martin Camaj, brenda datës 12 mars 2023, duhen rreth 6 000 euro;

4-Festimi i 20 vjetorit të themelimit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", me 13 maj 2023, duhen rreth 250 000 leke;

5-Vendosja e shtatores së Princit Lekë Dukagjini, brenda muajit qershor 2023, është komisioni i veçantë, që do të merren me sigurimin e fondit përkatës;

6-Marrja pjesë në veprimtari të shoqatave analoge në hapësirat shqiptare, duhen rreth 200 000 lekë;

7-Përgatitja e zhvillimi i konferencës së VI të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", në muajin shtator 2023, duhen rreth 60 000 leke.

Gjithsej duhen 906 000 leke dhe 6 000 euro.

\*\*\*

Na u priftë e mbara ne vijimin e realizimit të Misionit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", dhje për vitin 2023.

**NDUE SANAJ**

Kryetari i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"

# XHUBLETA MALËSORE, KJO PASURI KOMBETARE SHQIPTARE TASHMË NËN MBROJTJEN E UNESCO-S

Data 29 nëntor 2022 do të njihet si dita ku zyrtarizohet pranimin e Xhubletës Shqiptare në UNESCO - Organizatën për Edukim, Shkencë dhe Kulturë të Kombeve të Bashkuara, e cila merr në mbrojtje pasuritë më unike (të rriskuara) në botë, dosja e së cilës kishte kaluar fazën e shqyrtimit ditë më parë. Lajmin për këtë sukses dhe arritje të qeverisë Shqiptare e shpërndau vetë Ministria e Kulturës znj. Elva Margariti. Dhe s'kishte si të ndodhte ndryshe pasi xhubleta është unike në botë në llojin e saj dhe tejet e rrallë për nga vjetërsia mbi 4500 vjeçare.

Jetëgjatësinë e saj e përcaktojnë një sërë faktorësh ndër to, teknikat e punës me të cilat punohet edhe sot kjo veshje, që janë tjerrija dhe ëndja, dy teknika këto të shpikura që në periudhën e neolitit dhe lënda e parë "lesh" me të cilin prodhohet, produkt i përfutur që nga lindja e blegtorisë në antikitet. Xhubleta është trashëgimi e pastër etno - kulturore shqiptare, rrathët e së cilës shtrihen në hapësirën natyrore rreth Alpeve Shqiptare dhe është petku, me të cilin identifikohen malësorët, bartës dhe trashëgimtar të saj.

Falë kësaj pasurie, ne sot krenohemi për vlerat e saj si dhe identitetin me të cilin na pajis kjo veshje. Vetë malësorja nën petkun e xhubletës vishej me virtytet më të larta humane në habitatin e saj. Ajo quhej mbretëreshë, trimëreshë, amanetqare, fisnike e të tjera. Xhubleta për malësoren ishte si një mantel mburoje, pasi materiali i ngjeshur i saj e mbante të mbrojtur trupin e gruas dhe i ruante shëndetin e mirë. Edhe si veshje është shumë praktike çka i jepte përparësi gruas në lëvizje, në punë, në ecje e deri në demonstrimin e trimërisë për vetëmbrojtje. Veç këtyre cilësive xhubleta, është tepër e hijshme dhe e përshtatshme për ndryshimet stinore. Ajo me cilësitë e saj pasqyrore gjendjen shpirtërore të malësores dhe identin e saj krahinor. Në stilim, në simbole e në ngjyra çka përcaktonte edhe tipologjinë e xhubletës.

Në kulturën shpirtërore të malësorëve xhubleta përfshinte gjithçka që lidhej dhe bashkëjetonte me gruan në mjedisin social dhe natyror ku ajo banonte. Sot xhubleta ekziston falë atij fanatizmi kulturor që vetë malësorët kanë trashëguar në shekuj, në përpjekje për të ruajtur edhe strukturën racore të tyre, për çka ndihemi shumë krenarë për identitetin tonë si malësore dhe bij të kësaj veshje kaq fisnike.

Na lumturon fakti se sot XHUBLETA do të njihet si "PASAPORTA E IDENTITETIT KULTUROR KOMBËTAR SHQIPTARË", në mes të kësaj game të gjerë të trashëgimisë botërore, e cila njëkohësisht do të ketë edhe mbështetjen dhe mbrojtjen e kësaj organizate ndërkombëtare, përballë rrezikut të asimilimit kulturor global.

Mirënjohja më e thellë për këtë ar-



ritje të qeverisë shqiptare shkon për nënëloket malësore, të cilat na e trashëguan këtë botë të pasur shpirtërore të mishëruar në xhubletë. N 'prehen t' saj ato u linden, u rritën dhe mësuan virtytet e fisnikërisë, mençurisë, sakrificës, madhësisë, dëlirësisë e dashurisë për jetën dhe familjen ndaj e kemi obligim ta vlerësojmë në jetë të jetëve këtë pasuri të lënë amanet për ne, bijtë e saj të mirë edukuar prej frymës së tyre, që ta ruajmë dhe ta trashëgojmë në të dy degët e pemës gjenetike atë të lisës së gjakut e të tamblit, sa do larg vendlindjes të endemi në këtë fshat të vogël global.

Shkruar nga  
Rita Shkurtaj

# FESTIVALI BURIMOR 2022, NGA ANSAMBLI FOLKLORIK "TREVA"

Tashme është bere traditë që çdo fundviti, ansambli folklorik "TREVA" e Dukagjinit të organizojë natën tradicionale me këngët, meloditë dhe vallet më të bukura të vitit, duke e kthyer festivalin burimor në një manifestim burimor, për ruajtjen dhe pasurimin e trashëgimisë kulturore si pasuri e çmuar kombëtare, duke sjelle të vjetrën tonë dhe të rene në varg, melodi, veshje e interpretim, që të mbetet si një kujtim i bukur i çdo viti.

Edhe sivjet u organizua një veprimtari e tille me datën 4 dhjetor 2022, në mjediset e teatrit "MIGJENI", me krijimet folklorike më të mira të vitit, me artiste të rinjë e të vjetër të Dukagjinit.

Veprimtaria zhvillohet në një ambient shumë mbresëlënës, që rreth një trevezë është grupi artistik me këngëtarë, valltare e instrumentiste, me veshje tradicionale, me rroba shumëgjyreshë, me xhubletën e cila tashmë mbrohet nga "UNESCO".

Koncerti hapet me vallen e kënduar nga ansambli "Treva" me titull: "JEM DUKAGJINET E LEKES", një gjurmë shumë e vjetër e besëlidhjes së dukagjinave, e sjelle në një mënyrë të brilante në skenë, që në disa vargje të sajë theksohet: "Jena dukagjinët e lekes / Te betuar për jete te jetës / Mbi trojet e "Sardes vjetër" / Jena ne e askush tjetër" ...

Si në çdo veprimtari gëzimi është traditë që të filloj me një kënge kushtrimi (me një kënge maja krahu), edhe kësaj radhe filloj me një kënge të tillë e kënduar nga Pjeter Shytani, me një zë brilant si askush tjetër në llojin e vet me vargjet: "Ç' janë këto gjame që po i sjell moti / Dukagjini nder i kombit".

Lahuta e jonë Shqiptare, si bashkudhëtarja e historisë, ishte prezentë edhe në këtë koncert, që i biri i lahutarit të parë me më emër në Dukagjin e më gjerë, Gjergj Pëllumbi i Thethit, Lulash Pëllumbi u paraqit me një kënge për kreshniket e Dukagjinit, të cilën e interpretoj në mënyrë shumë cilësore.

Të entuziazmon fakti, që edhe të rinjë i bien dhe i këndojnë lahutës siç ishte Emanuel Suka në këtë koncert.

U vijua me këngën "Për ty Dukagjin" nga këngëtarët e Trevës: Gentjan Kodra dhe Bledar Hysenaj.

Shumë denjësisht u paraqit grupi i shoqatës "Besa Shosh", të cilët përshëndeten të pranishmit me dy kënge: -Vëllezërit Ndue e Ndoc Fusha me këngën "Vendlindja ime" dhe këngën "Zot i arbit-Gjergj Kastrioti", me solist Gjelo Kule Fusha, shoqëruar nga grupi.

Si zakonisht, edhe në edicionin e 19-të, të kësaj veprimtarie edhe aktivizimi i këngëtarëve të rinjë siç ishin: Prele Rushaj nga Toplana, me Gjergj Kole Ndreun, të cilët u paraqiten me një kënge tipike bjeshke.

Këngëtari i preferuar dhe i talentuar Bardhok Lucaj interpretoj një kënge për Mark Lulen e Shalës, i cili fitoj shumë duartrokitje.

E ftuar special ishte këngëtarja tropo-

jane Mirjeta Celaj, e cila u paraqit me këngën "Zjarr dashnie", me vargjet: "-Moj e mire që shkon në krue / -Mos merr shoqe se gjen mue" ...

Fillon kënga lirike bjeshke e kënduar nga këngëtari Sokol Gjoni.

Aurela Musheqi u paraqit me këngën: "Lulja çel kur vjen pranvera".



Si gjithnjë, në këtë veprimtari nuk mungoj humori nga grupi "Gaz e maraz" si dhe parodisti i talentuar Dukagjinasi, nga Boksi Gege Shpati.

Gentjan Gropaj e Blendar Hysenaj,

Reka u paraqiten me këngën: Në këtë jete hallet ndahen, / gjysma kjahen e gjysma s' kjahen"...

I përhershmi dhe këngëtari i mirënjohur Gjovalin Shani, u paraqit me një kënge për bjeshkët e Dukagjinit, që u shoqërua me ovacione ...

Profesori i muzikës Preke Mrishaj u

paraqit me një kënge lirike.

Këngëtari i ri, shumë i pasionuar Noel Pjetri u paraqit me një kënge lirike: "-Koha shkon e nuk na pret".

Këngëtari Kristjan Zalli ka ardhur en-



Emanuela Necaj dhe Mirela Brushtulli, paraqiten një kënge lirike me vargje: "-O ju vajza, o ju vajza / -Nuk ju bien dashnin unaza / -O ju djem, o ju djem të rinj / -Frikacak në dashuri".

Dyshja tashmë shumë e kërkuar dhe e dashur për publikun, Fran Kodra dhe Ndue Shytani u paraqiten me këngën: "INTERNETI", në të cilën theksohet: "-Doli facebuku / -Me shoqëri na zhduku / -Vaiber e Watshapi / -Po na shkon sathati" ...

Dueti simpatik, Leonard Pjetri e Luiza

kas nga Italia, për këtë koncert dhe interpretoj këngën me titull: "-Erdhi fati".

Fran Kodra dhe Mirjeta Celaj interpretojnë për Nenën, të cilët plotësuan shumë mirë njeri-tjetrin dhe ngjallën shumë emocion tek spektatori, sidomos tek ata, të cilëve ju mungon "Nena".

Këngëtari i ri Zef Marku interpretoj këngën: "Mos ti lemë zemrat me plas".

Edhe këngëtari Gjini Shani, me zërin e tij shumë melodioz, përshëndeti të pranishmit me këngën: "Njësoj jena para zotit"

Si gjithnjë edhe kësaj radhe, këngëtari i talentuar Zef Beka e beri spektatorin për vete me paraqitjen e tij skenike, i cili këndoj këngën: "Kënge për shaljanet", në të cilën theksohet: "-Si shaljane thonë për urti / -Si shaljane thonë për trimëri / -E kane thënë e kane me thane / -Sa të bajne drite, diell e hënë" ...

Përsëri Kodra, Shytani dhe Fierza, interpretojnë cilësisht këngën: "Po knon gjeli", e cilën e pëlqyen të pranishmit, në të cilën theksohet: "-Po knon gjeli ki-ki-ki / -A je çua o syni i zi / -Te tan natën bashke këna fjet / -Rahati nuk këna gjet" ...

Këngëtari i mirënjohur Ndue Shytani interpretoj solo këngën: "O sa mire kur ishim keq", në mes të tjerave theksohet: "-Te bashkuem kena kenë dikur / -Sot te ndare mos me u mbledhë kurrë / -Dikur ngrohte në një voter, / -Sot s' bashkohen vëlla e motër" ...

Pothuajse të gjitha këngët ishin të reja, të krijuara nga kantautori i-600-kengeve, Fran Kodra.

Të gjitha këngët u shoqëruan nga grupi i valleve të shoqërisë kulturore "KOHA E DINOSHES", që mbyllën edhe veprimtarinë.

Për zhvillimin e kësaj veprimtarie kontribuuan disa mundësor:

-Bashkia Shkodër, e cila mundësoj

"TEATER MIGJENI" në dispozicion;

Dukagjinasi me banim në Nju-Jork,

Kujtim Funiçi e Ndoc Suka;

-Firma "XHEDIS";

-Restorant "PARISI";

-Bar-Kafe "Lami", me pronar z.

Bardhok Lami;

-Pal Gjubini;

-Sander Fran Shytani e të tjerë.

Organizatorët e këtij festivali ishin:

-Udhëheqës artisti, Fran Kodra

-Udhëheqës organizativ, Ndue Shytani.

-Udhëheqës muzikor, Luan Dakistani

-Koreografi, Aldo Nika.

Këta, u bënë 19-vite, që mbajnë

gjalle folkun tradicional dhe nga viti

në vit po e pasurojnë trashëgiminë

kulturore të Dukagjinit e më gjerë.

Ata, përveç se janë misionarë të

kësaj vlere kombëtare, janë edhe

eksperte për të na sjelle risi të reja çdo

fundviti, duke zbuluar zëra dhe talente

të rinjë dhe duke i promovuar në këtë

veprimtari.

Moderatore ishte gazetarja e mirënjohur

Kozeta Bruçi.

Me që është festival, i ka ardhur koha

me pas edhe juri, për me dhanë edhe çmi-

met e nevojshme, nëpërmjet të cilave nx-

itet më shumë interesi dhe konkurrenca.

Për këtë duhet bashkëpunuar edhe me

krijues dhe interpretues të tjerë.

Suksese në të ardhmen grupit folklorik

"TREVA"!

**PRELE SHYTANI**  
Dhjetor, 2022

# AT AMBROZ MARTINI, NË 94 VJETORIN E LINDJES SË TIJ

- Veprimtari përkujtimore nga Shoqëria Kulturore "Besa Shosh" -

Si sot, 94 vite më parë, pikërisht me 2 dhjetor 1928 është lindur At Ambroz Martini, një ndër klerikët që bëri aq shumë për Shqipërinë, e pati atë gjithmonë në zemër dhe i shërbeu krishterimit për 50 vite në 5 kontinente. Do të shërbenin vetëm këto pak të dhëna për të zgjuar kërshërinë dhe njohur personalitetin e At Ambrozit, tek të gjithë ata që nuk e kanë njohur, por edhe tek miqtë e të afërm, bashkëkohës të tij që kanë jetuar e punuar me të.

Në fakt është një histori e tërë që të zgjon: krenari, drithërim, dhimbje, zhgënjim, indinjatë, e për tu mbyllur me dashuri e humanizëm. Një histori që të trondit, që nga pushkatimi, arratisja, internimi, shugurimi, veprimtaria atdhetare e patriotike në dhe të huaj, e deri tek kontributi në tokën e të parëve, pas 50 vitesh larg atdheut.

Janë dokumentet, dëshmitë edhe të atyre që sot nuk jetojnë më, regjistrimet në Radio Vatikan, e të tjera, të cilat janë radhitur kaq mirë, me një gjuhë të thjeshtë në dokumentarin "Shtigjet e lirisë".

Duke qenë se ne zgjodhëm datën 2 dhjetor, pikërisht ditën e lindjes së At Ambrozit, le të mos e konsiderojmë ditën e sotme si një ditë të trishtueshme, por si të gëzueshme, pavarësisht se gëzimi dhe vuajtja janë bashkudhëtarë në jetë.

Sot, vlerësojmë figurën e At Ambrozit, e për ta bërë këtë zgjodhëm paraqitjen para jush të dokumentarit "Shtigjet e lirisë", me autor Mhill Vatën.

Le të ndalemi pak tek dokumentari si gjini televizive. Nuk është aspak e lehtë që jeta e një personaliteti të përfshihet në 60 minuta, ashtu siç është me shumë vlerë që publikut, i cili e ka të vështirë të gjejë kohën për të lexuar libra, të marrë thelbin dhe t'i bëhet mjaft e njohur biografia, shkaqet, pasojat, e gjithë rrugëtimin të At Ambrozit, apo kujtdo tjetër që e meriton vëmendjen tonë.

Realizimi i dokumentarit "Shtigjet e Lirisë" u mbështet nga Shoqëria Kulturore "Besa e Shoshit", me iniciator nipin e të ndjerit At Ambrozit, Ndoc Fusha, kryetari i kësaj shoqate.


Dokumentari, me autor Mhill Vata, një mjeshtër në gjininë e dokumentarit, njohës i mirë edhe i mendësisë e historisë së gjithë trevës së Dukagjinit, të mban të gozhdur në renditjen e fakteve, të cilat nuk kufizohen vetëm në rrjedhën e jetës së At Ambrozit, që nga koha kur ai fillimisht u pagëzua me emrin Zef, por paralelisht do të vijnë edhe mjaft fakte që sjellin historinë e dhimbshme, që kaloi vendi një gjatë sistemit të diktaturës komuniste.

Teleshikuesit teksa mësojnë fakte të reja, do të kuptojnë më mirë raportet shkaku-pasojë, fatin e nëpërkëmbur të njeriut, të cilit vetëm një shpirt i vullnetshëm me ndihmën e një shpirti hyjnor gjen rrugën e duhur dhe realizon idealet e tij.

Rrëfimet e sinqerta, plot kujtime të ngulitura e të konservuara në mendjet e të afërmeve, në atë dialekt të mrekullueshëm gegnishte, të emocionojnë, e të përlojnë njëherësh. Do të veçoja shprehjen e

ushtri. Zefi u caktua të mbante këndin e emulacionit. Si shumë klerikë, u arrestua për punë armiqësore. Pas 30 ditëve torturash, nxirret para pushkatimit. Ndodh ajo që nuk pritej. Shoku i tij, Gjëlosh Lu-

shugurohet meshtar. Emri i tij, sipas rregullave kishtarë, nga Zef ndërrohet në Ambroz. Pasi ka shërbyer për vite të tëra në Evropë, At Ambroz Martini, më 1970 shkon në USA.



motrës së At Ambrozit: "300 herë e kam kqyr diellin se kam than s'kanë hall pa e pa edhe ata, e na përpiqen drita e syve ndër vedi"

Une nuk dua të ndalem më shumë në detajet e ngjarjes.

"Me ka ruajt i madhi Zot dhe e kam ndërjet veten në borxh e në pamundësi",- shprehet At Ambroz Martini.

Pse e ka ruajt Zoti?

Pse u ndje në borxh?

Pse e kishte të pamundur?

Për të marrë përgjigjet, ju ftoj më të ndiqni dokumentarin "Shtigjet e Lirisë", me autor gazetarin e mirënjohur Mhill Vata.

## Jeta e At Ambrozit

Historia e familjes së Marash Nokës do të niste nga Okoli i Thethit. Dy nga 6 fëmijët e kësaj familje do i dedikoheshin krishterimit, Zefi dhe Orselina. Zefi është lindur më 2 dhjetor 1928, një dritë jete e dhuruar nga shpirti prindëror, por edhe ai hyjnor.

50 vjet më parë ai u shugurua në tokë të huaj, pasi Shqipëria gjendej në monizëm.

U largua nga atdheu i ndjekur nga persekutimi dhe vala e shkatërrimeve ndaj kishave

Kreu kolegjin françeskan, liceun "Illyricum". Në 14.12.1946 u mbyll shkolla françeskane. "Na kane rrethu kuvendin e për 40 minuta na urdhëruan se duhej me marr teshat tona",- shprehet At Ambrozi në dëshminë e tij.

Më 12. 1. 1947 u detyrua të lërë rrugën e tij drejt formimit fetar dhe të mobilizohet me Lin Delinë (piktorin e njohur), në

lashi, pret plumbat dhe mori përsipër akuzat ndaj Zefit.

Pas kthimit nga ushtria, Zefi mori vëllanë, Palin, e dolën në bjeshkë, aty ku veronin me bagëti familja. Çdo gjë u planifikua në pak kohë. Lëshoi gurët poshtë shpatit si sinjal që kaluan vetë i treti kufirin. Motra murgeshë, për t' mos rënë në duart e diktaturës, shkoi në Zllakuqan, fshat në bashkinë e Klinës në Kosovë.

Më 27. 7. 1948, me vëllain Palin dhe Lin Delinë largohen drejt ish Jugosllavisë. Nisi kështu rrugëtimin për realizimin e idealit françeskan, në 5 kontinente, për fenë katolike e Shqipërinë etnike.

Për ata që mbetën nisi persekutimi. Policia mori nenën e babën pas 4 ditëve nga arratisja. Familja u izolua në kodrën e Shën Gjergjit, mes Shalës e Shoshit. Mes të rriturve edhe dy fëmijë të vegjël. Më pas kthehen në Theth, por dera e Martin Nokës do të ishte në survejim. Pas pak kohe familjen do e transferonin në Vlorë. Lëvizje pafund për tu ndalur në Tepelenë. Herë me bukë e herë pa bukë. Jetuan në një stallë mushkash, as dritë, flinin në çimento. Vuajtje për familjen Noka do të vijonin edhe pas Tepelenës.

Në vitin 1948, Zef Martini do të shkonte në Hercegnovi, ku do të ndiqte për 4 vite shkollën në pikturë, dhe do të punonte më vonë si profesor në Vladimir.

Në 1952 burgoset nga autoritetet jugosllave, me akuzë pasi ndihmonte çështjen nacionaliste shqiptare, por lirohet brenda vitit.

Në vitin 1953, gjatë studimeve në universitet, bie në kontakt me ambasadën italiane dhe më 12. 1. 1955 kalon në Itali, falë ndihmesës së At Daniel Gjeçës.

Vlera më e madhe e At Ambrozit qëndron tek korrespondenca, i cili mbajti me patriotë në emigrim. Një punë e jashtëzakonshme për atdhetarizmin e shqiptarëve, e që patër Ambrozi e bënte në heshtje. Ai ishte një figurë komplekse, karakter i fortë, i drejtpërdrejtë, ia thoshte të vërtetën përballë çdokujt, e ka dashur të vërtetën. Shpërndante butësi, ëmbëlsi. Plot pasion, dashuri dhe dhimbje për atë që ka kaluar atdheu i tij, dhimbjen që ka shkakuar komunizmi mbi meshtarët.

Nga Kalifornia u kthye në Belgjikë. U shërbeu shqiptarëve për 3 vite atje. Do të qëndronte përkrah Dom Prekë Ndrevashës dhe Dom Daniel Gjeçajt, në përkujtimin e figurës së Gjergj Kastriotit, Heroit tonë Kombëtar.

Në vitin 2000 u kthye në vendlindjen e tij, në Shkodër. "Vetëm tash kam gjet parajsën e vërtetë",- u shpreh At Ambrozi, gjatë një interviste të tij në dokumentar. Këtu gjeti njerëzit që e donin Zotin dhe e respektonin.

Në vitin 2002, At Ambroz Martini, dha meshë në Bjeshkët me Name, mes Jezercës e Radohimës. Ka meritën se, pasuroi bibliotekën e françeskanëve në bashkëpunim me Patër Daniel Gjeçën, me libra, kaseta, regjistrime të figurave historike, të cilat kanë dhënë shumë për kombin. Kampanieli i kishës françeskane në Shkodër është meritë e At Ambrozit, si një ndihmë ekonomike dhe shpirtërore ndaj besimtarëve, që kanë ruajtur fenë, atdhëne e dashurinë për Zotin.

Deri në moshën 82 vjeç, At Ambrozi bëri një jetë aktive, edhe pse kaloi 2 operacione kardiake.

# Xhelozia: Çfarë është dhe, kur duhet të mendohet problem

Xhelozia është një ndjenjë të cilën, e njohim të gjithë madje, që në fëmijërinë e hershme. Por, meqenëse ka një nam shumë të keq, të gjithë mundohemi t'a fshehim. Vështirë se dëgjon dikë të thotë: Po, unë jam xheloz.

Psikologët mendojnë se, instinkti i xhelozisë, është i lashtë. Kjo vihet re më shumë tek disa lloje kafshësh dhe tek fëmijët. Në familjet e lashta konkurrenca për ushqim dhe përkujdesje ishte shumë e madhe. Bëhej fjalë për të mbijetuar prandaj, gjithkush e shikonte tjetrin si konkurrent. Xhelozia shërbente si sinjal rreziku. Edhe xhelozia romantike, bashkëshortore, nuk është e re. Mendohet se, që në Epokën e Gurit, bashkëshortët ishin xhelozë ndaj njëri-tjetrit. Asnjë burrë i Epokës së Gurit, nuk ishte i gatshëm të rriste dhe të ushqente fëmijët e huaj. Gratë, materialisht, ishin të varura nga burrat. Një rast tradhtie brenda familjes, do të thoshte, rrezik për jetën e fëmijëve dhe, të gjithë familjes.

Qëllimi kryesor i paraardhësve tonë ishte, ruajtja, përhapja, trashëgimia e moralit dhe mendësive të tyre. Me kalimin e kohës, xhelozia u bë pjesë gjenetike e njeriut. Xhelozia mund të shfaqet në çdo rast të marrëdhënieve midis njerëzve, pavarësisht nga mosha, gjinia, pozita sociale. Në vitet e fëmijërisë, fëmijët janë xhelozë brenda vëllazërisë, për mënyrën e trajtimit nga prindit. Xhelozia e të rriturve, brenda miqësisë, një rrethi shoqëror, në punë dhe, kudo, është shumë e njohur.

Nëse bëhet fjalë për xhelozinë, në një grup, bashkësi apo partneritet, duhen menduar konflikte.

Njeriu xheloz, ndjehet i lënë pas dore, i mënjeluar, i injoruar nga të tjerët. Kjo e bën të ndjehet shumë keq, e përjeton me shumë dhembje, deri në sëmundje.

Xhelozia, është një emocion fare normal dhe i zakonshëm i cili, krijohet nga frika e humbjes së njerëzve të dashur ose, të vlefshëm për jetën tënde. Me ata njerëz, ti ke një lidhje të brendshme dashurie dhe, frika e humbjes së kësaj lid-

hje, krijon xhelozinë. Me ata që nuk ke lidhje, nuk bëhesh kurrë xheloz. Në rastet kur rrezikohet apo, dëmtohet kjo lidhje, shkakton një goditje shpirtërore, traumë psikike.

Forca vepruese e xhelozisë, tek njerëzit, shfaqet në intensitet të ndryshëm. Ndërkohë që dikush, ndjenë një pështjellim të stomakut, kur e shikon gruan/burrin e vet me një huaj, dikush tjetër turret me thikë ose kobure.

Më së shumti, kjo varet nga personaliteti i njeriut. Më të ndjeshëm janë tipat:

- fanatikë
- ata që vuajnë nga komplekse inferioriteti
- tipat e traumatizuar nga përvoja e keqe me dashurinë
- tipat e rritur në familje patriarkale
- tipat e varur emocionalisht dhe materialisht nga të tjerët
- tipat që vuajnë nga çrregullimi të forta të psikikë apo të personalitetit.

Psikologët mendojnë se, shkak kryesor, duhet kërkuar në fëmijërinë e hershme.

Psikologu anglez, Kevin Dutton (1967) thotë: "Njeriu, të gjitha ligësitë, i mëson në familje. Fillon me gjënjestrën, shpifjen, duhanin, alkoolin, drogën dhe, deri në mord".

Shumë nga tipat që vuajnë nga xhelozia, në fëmijërinë e tyre të hershme, kanë përjetuar lidhje të pasigurta. U kanë munguar lidhjet me njerëzit e afërt, babai i ka braktisur dhe, janë rritur vetëm me nënën. Frika e braktisjes, është rrënjëzuar thellë në psikikën e tyre e cila, nuk u ndahet gjithë jetën.

Si pasojë e sëmundjes së xhelozisë, jeta bashkëshortore përjeton gjendjen e krizës, të padurueshme. Rrjedhojat e krizës, nuk mund të parashikohen. Nëse zgjidhet paqësisht, me dhunë, me gjakosje, me largimin e njërit apo... nuk mund të thuhet. Sot, megjithëse kanë ndryshuar kushtet, rreziku nuk mendohet më aq i madh, xhelozia, ka mbetur po aq e madhe, sa atëherë. Kjo vërteton

se, kjo ndjenjë, është spirancuar thellë në psikikën tonë, është problem gjenetik. Krahas faktorit gjenetik, në zgjimin, aktivizimin dhe nxitjen e kësaj ndjenje, rrol të madh luajnë edhe faktorët mjedis, kultura, niveli i civilizimit. Në popujt e kulturës patriarkalo-orientale, ku, mjerisht, bëjmë pjesë edhe ne si komb, xhelozia, dominon gjithë jetën bashkëshortore dhe familjare. Burrat kanë të drejtën në çdo rast të jenë xheloz ndaj gruas. Zakoni ua jep të drejtën që të sillen dhe t'a trajtojnë gruan, sipas dëshirës dhe vullnetit të tyre. E mbulojnë me shami, me burka, e fyejnë e dhunojnë madje, edhe e vrasin. Në shumë raste, vetëm se është femër. Kjo sjellje, në gjuhën juridike, mendohet femicid. Gratë, nuk guxojnë të tregohen xheloze, ndaj burrit të tyre. Burrat janë të lirë, mund të bëjnë çfarë të duan dhe, të sillen si të duanë.

Shkencëtarët, akoma nuk kanë arritur në konkluzionin se, cila gjini është më shumë xheloze se tjetra. Është vërtetuar se, burrat dhe gratë, e shfaqin xhelozinë në mënyra dhe, për arsye të ndryshme. Gratë preken më shpejt nga tradhtia emocionale ndërkohë që, burrat, e humbasin logjikën nga tradhtia trupore.

Gratë vuajnë nga tradhtia dixhitale, më shumë se burrat. Në ditët e sotme, rrjetet mediatike sociale, janë burim i konflikteve në familje.

Shumë mendojnë se, xhelozia, në jetën bashkëshortore, është e mirë, është mbrojtëse e dashurisë. Por, çfarë thonë psikologët?

Psikologët kanë përcaktuar tri lloje xhelozie:

1. Xhelozia reaktive. Kjo shoqërohet me shpërthim emocional, në raste konkrete kur, njëri nga bashkëshortët e kap tjetrin në flagrancë me një të huaj.
2. Xhelozia e mosbesimit. Njëri nga bashkëshortët, vuan vazhdimisht nga mosbesimi tek tjetri. Kjo e bën që, ai, të zbatojë principin e „kafazit“. E kontrollin vazhdimisht, gjithku dhe për

gjithëcka, e dhunon psikikisht dhe fizikisht, e ndalon në kontaktet me të tjerët, i dikton veshjet, ia ndalon aktivitetet jashtë mureve të shtëpisë.

3. Xhelozia e pushtetit në familje. Burrat e kulturës patriarkale, nuk kanë aspak qejf që t'a ndajnë apo delegojnë pushtetin në familje. Të gjithë pushtetin duan t'a përqendrojnë në dorën e tyre. Ia bllokojnë gruas të gjithë rrugët dhe mundësitë e zhvillimit mendor, intelektual dhe, fizik. Mundohen t'a bëjnë sa më të vogël, mundësisht të padukshme dhe të padëgjueshme.

Nga të tria format e shfaqjes së xhelozisë, psikologët mendojnë se, rasti më i „pastër“ është xhelozia reaktive. Edhe në këtë rast, dhuna nuk justifikohet, mendohet veprim kafshëror. Ai që përdorë dhunën mbi „fajtorin“, vërteton se, kurrë nuk e ka dashur. Ndoshta ka pritur rastin për t'a hequr qafe dhe...bam.

Xhelozia, në jetën bashkëshortore, në të gjitha rastet dhe format e saj mendohet brejtës i jetës bashkëshortore por, nëse shfaq këto simptoma, duhet menduar problem:

1. Mosbesim i hapur.
  2. Fajësime permanente të tjetrit, ku dhe, me cilin.
  3. Reaksione emocionale, të vazhdueshme, për çdo vogëlsirë, buzëqeshje, përshëndetje, mesazhe telefonike etj.
  4. Kontrollë permanente të tjetrit, gjithku dhe për gjithëcka deri në mohimin dhe rrënimin e sferës private.
  5. Gjurmimi dhe spiunimi i partnerit me persona të tretë.
  6. Mbyllja e femrës brenda katër mureve të shtëpisë.
  7. Ndalimi i kontakteve sociale.
  8. Detyrimi i veshjes deri dhe mbajtja e shamisë së kokës apo burkës, jashtë vullnetit të bashkëshortes.
  9. Bllokimi i llogarisë personale, përqendrimi i të ardhurave në një dorë të vetme.
  10. Kontrolli për shpenzimet ditore, deri në cent.
- Nëse bashkëshortët, përjetojnë simptomat të tilla, duhet të mendojnë se, jeta bashkëshortore ka përfunduar me kohë. Ata vetëm bashkëbanojnë por, nuk bashkëjetojnë.

**Lekë Imeraj,**  
shkrimtar, përkthyes, publicist

Më 4. 2. 2010 i dha lamtumirën kësaj botë. U përcoll për në banesën e fundit me nderime të mëdha dhe një ceremoni që do mbetet gjatë në kujtesën e qytetarëve në Shkodër.

\*\*\*

Duke iu rikthyer veprimtarisë, të organizuar nga Shoqëria Kulturorë "Besa Shosh", sot në Bardhaj, në ambientet e restorant "Rinia", shfaqjes së dokumentarit "Shtigjet e Lirisë" iu bashkëngjiti edhe një ceremoni, të cilën kurrsesi nuk do e quanim zyrtare. Përveç fjalës së iniciatorit dhe kryetarit të "Besa Shosh", zotit Ndoc Fusha, autorit të dokumentarit Mhill Vata, fjalën e morën edhe mjaft miq, të afërm e klerikë, menjëherë pas emocioneve që shkaktoi dokumentari i realizuar mjaft mirë. Mes tyre përmendim: Gjergj Leqejza-Konsull Nderi i Austrisë, Ndue Sanaj -Kryetari i Shoqa-



tës Atdhetare "Dukagjini", Prelë Milani-studiuës dhe publicist i njohur, Rita Kalaj-Kryetare e Shoqatës. "Xhubleta e Alpeve Shqiptare", Zef Toka- mësues në pension, Geg Zefi -këngëtar nga Shoshtit, Ndreka Deda- burri i nderuar nga Brashta e Shoshtit (shkrimtar), Mirash Kometa-

kushëri i At Ambrozit, klerikë, e të tjerë. Në fjalët e tyre ata sollën kujtime me At Ambrozin, vlerësuan organizatorët për veprimtarinë e realizuar, u bënë thirrje strukturave vendore për vendosjen e emrave të klerikëve më të njohur të Thethit rrugëve kryesore të tij, e të tjera.

Një pasqyrim më të detajuar të aktivitetit ju do të keni mundësinë ta ndiqni në emisionin "+355 Atdheu" të Albdreams Media.

**Kozeta Bruçi,**  
gazetare e RTV-1

# Dhe shkretëtira do të lulëzojë

10 vite më pare u nda nga jeta e Imzot Antonio Sciarra, Mesha përkujtimore në Blinisht dhe promovimi i librit të Brikena Lazri mbi jetën e veprimtarinë e tij.

Në 10-vjetorin e kalimit në amshim të Imzot Antonio Sciarra, u zhvillua Mesha e Shenjtë, në Kishën e Martirëve në Blinisht në orën 15.00, e kryesuar nga Shkëlqesia e Tij Ispeshkvi i Dioqezës së Sapës, Imzot Simon Kulli.

Në ftesën përkujtimore me këtë rast, ndër të tjera, kështu është shkruar:

Ne e kujtojmë me shumë mirënjohje për dashurinë që ka pasur për popullin shqiptar dhe për punën e madhe që ka zhvilluar në Zadrinë.

Qindra besimtarë të moshave të ndryshme, klerikë, intelektualë dhe personalitete vendore, morën pjesë në këtë kremtim. Ishte i pranishëm edhe një delegacion nga Dioqeza e Avezano-s prej nga ka ardhur edhe don Antonio si Misionar Fidei Donum (Dhuratë feje).

Menjëherë pas kremtimit eukaristik, të gjithë u spostuan në njërin prej sallave të famullisë ku edhe u zhvilluar promovimi i librit “Dhe shkretëtira do të lulëzojë”, një memuaristikë mbi jetën dhe veprimtarinë e famullitarit më popullor të Zadrinës. Autorja e librit, Brikena Lazri, e ka njohur nga afër don Antonion dhe ka ndier në zemrën e saj nevojën që të shkruajë një libër kujtimesh që vepra e misionarit Italian në mesin e popullit tonë të mos zbehet por të shkojë duke u ripërsëritur në vazhdim. Brikena Lazri, ka lindur më 23. 02. 1976, në fshatin Blinisht të Lezhës. Arsimin bazë dhe të mesëm e ka kryer në fshatin e lindjes dhe më vonë diplomohet në fakultetin ekonomik, dega Administrim Biznes, në

Tiranë.

Merret vazhdimisht me shkrime letrare, përkthime, publicistikë, kryesisht me temë fetare.



“Shkretëtira do të lulëzojë - Don Antonio Sciarra”, është vepra e parë që sheh dritën e botimit. Titulli i librit është frymëzuar nga një slogan i vazhdueshëm i protagonistit të librit, që edhe ai vetë është frymëzuar nga premtimi biblik plot shpresë: “Le të gëzojnë vendet e shkretëta e të papërshkueshme, le të galdojë shkretëtira e të lulëzojë si lili!” (Is. 35, 1)

Autorja deklaroi se nxjerrja në dritë e këtij libri është një punë kërkimesh dhe studimesh për vite të tëra dhe nuk ka pretendimin të jetë pa mangësi, madje ka guxim të t’u kërkojë të gjithëve që nëse gjejnë ndonjë gabim ta shprehin dhe nëse

duan të shtojnë ndonjë gjë rruga është e hapur.

Moderator i promovimit ishte vetë redaktori i librit të sipërpërmendur shkrim-



tari Ernest Marku, i cili e ka njohur protagonistin e librit dhe ka përjetuar përvoja të ndryshme me të.

Përveç Ispeshkvit Imzot Simon Kulli, iu dha fjala në mënyrë spontane të gjithë atyre që donin të jepnin një dëshmi lidhur me njohjen që kanë pasur me don Antonion.

Don Antonio Sciarra, prifti Italian, erdhi në Shqipëri në fundin e viti 1992, ku u mikprit fillimisht nga atë Luigi Amato edhe ai misionar katolik Italian, i cili kishte hapur aktivitetin kishtar në Shënkoll të Lezhës menjëherë pas rënies së regjimit komunist në Shqipëri. Në

muajt e parë të vitit 1993, pas një eksplorimi intensive të realitetit shqiptar sidomos në Veri të vendit, don Antonio mori vendim të vendosë “tendën e tij” në mesin e popullit të Zadrinës e pikërisht në fshatin Blinisht të Lezhës. Duke shërbyer si bari shpirtëror i 6 fshatrave, Blinisht, Piraj, Baqel, Krajen, Kodhel dhe Gjadër, don Antonio përjetoj mundime dhe trazira të pafund për 17 vite, duke lehtësuar vuajtjet shpirtërore dhe fizike të këtij populli të plagosur.

Në fillim të vitit 2008, don Antonios i shfaqet sëmundja që do ta çojë në një operacion në kokë e do të kalojë në amshim, më 8 dhjetor 2012 në spitalin e Avezano-s. Don Antonio e la me amanet që të varroset në Blinisht, prandaj edhe trupi i tij prehet pikërisht në këtë fshat pranë Kishës së Martirëve të shenjtë shqiptarë.

Kopjet e Librit mbi jetën e don Antonio Sciarra, që është shkruar me shumë dashuri, me dëshirën e autores janë vënë në dispozicion të plotë të famullitarit aktual, don Alberto Galimberti, që pas don Enzo Zago është pasuesi i dytë i protagonistit të librit.

Përfitimet që do të nxirren nga libri do të jepen të gjitha për bamirësi për aktivitetet e Kishës.

Dëshiroj të falënderoj nga zemra Zotin e gjithësisë që na ka dhënë një shembull frymëzues si don Antonio Sciarra, i cili do të kujtohet sigurisht nga brezat e ardhshëm si një bari i mrekullueshëm, si humanisti që me vetëflimimin e tij bëri realisht të lulëzojë shkretëtira në tokën e Zadrinës. Zonjës Brikena Lazri, autores së librit, i urojmë nga zemra suksese të mëtejshme!

Tashmë don Antonio nuk është fizikisht në mesin tonë, me aktivitetet e tij të zakonshme që gjallëronin ditët e fshatrave tona, por do të vazhdojë të jetë i pranishëm me shembullin dhe Idealin e tij.

## Një shembull ideal për të gjithë

Më së pari dëshiroj të falënderoj Zotin që bashkëfshatarja jonë Brikena Lazri ka ndërmarrë këtë punë fisnike dhe sigurisht angazhuese për të shkruar një libër mbi personalitetin e don Antonio Sciarra, i cili meriton më shumë se kaq për përkushtimin dhe vuajtjet që përjetoj duke i shërbyer popullit tonë.

Don Antonion pata fatin ta njoh dhe të jetoj me të që në ditët e para që shkeli në tokën shqiptare. Atëherë unë isha nxënëse në Shkollën e Mesme të Bashkuar në Shënkoll të Lezhës, ndërsa banoja në Institutin e Etërve Rogacionistë që ishin misionarë në të njëjtin vend. Asokohe, mendoj në dhjetor të vitit 1992, don Antonio kërkoi mikpritje nga Etërit Rogacionistë, që të eksploronte zonën e veriut ku donte të ngulte rrënjët si misionar.

E kujtoj me mall se një ditë më thirri në zyrën e famullisë dhe më pyeti për fshatrat e Zadrinës dhe më kërkoi në cilin fshat do më pëlqente ku ai të vendosej si famullitar i ardhshëm. Duke menduar faktin se Blinishti edhe gjatë regjimit ko-

munist ishte qendër për fshatrat përreth dhashë mendimin tim që të ndalej në këtë fshat. E kështu ndodhi.

Kujtoj me mall faktin se drekën e parë në Blinisht e bëri tek familja ime. Ishte plot zell në çdo lëvizje. Në Institutin ku unë isha ai na mësonte vazhdimisht tema mbi Ungjillin, Kishën, jetën sociale dhe gjithçka e bënte me entuziazëm dhe në një mënyrë që na linte të kënaqur. Luante me fëmijët dhe me të rinjtë dhe krijonte kudo një klimë pozitive dhe të këndshme. Që në fillim na kërkonte të gjithëve ta quanim vëlla Antonio, sepse donte të bëhej një me të gjithë dhe ta konsideronim si një vëlla të thjeshtë në mesin e vëllezërve.

Kam shumë kujtime pozitive dhe përvoja të bukura me të që nuk do të shlyhen kurrë nga kujtesa ime. Dinte t’i përfshinte të gjithë në aktivitetet fetare dhe shoqërore që ai drejtonte duke fituar në shumicën e rasteve simpatinë e besimtarëve.

Më shprehte gjithmonë vuajtjen që kishte kur shqiptarët dilnin jashtë shtetit duke lënë kështu vendlindjen e tyre në

kërkim të një jetese më të mirë.

Më ka bërë përshtypje fakti se edhe në mesin e vështirësive dhe të përgjegjësive të shumta ai kishte edhe një sens humori që shtonte gjallërinë e çdo takimi me të.

Ndër përvojat më të forta me don Antonion, kujtoj përfshirjen që kam pasur në shtegtimin e Zojës së Velës nëpër fshatra dhe kampin veror në Krajen në vitin 2008. Atë vit ka qenë një eksperiencë e fortë jete, vit në të cilin kam jetuar bashkë me don Antonion, don Enzon dhe misionaren laike Elsa.

Kam vënë re se ishte i kujdesshëm edhe për hollësitat dhe megjithëse kishte një karakter të fortë në punë dhe ishte i rreptë në kryerjen e përgjegjësive, dinte mjaft mirë të shprehte edhe dashurinë dhe ngrohtësinë shpirtërore, tipike të bariut të mirë të shpirtave.

Nuk ndalej përpara pengesave dhe vuajtjeve të ndryshme që kishte mësuar t’i përballonte me kthjelltësi. Ndonëse me pak, donte t’i ndihmonte të gjithë. Pasi u sëmur rëndë pas 17 vitesh si mis-

ionar në Blinisht dhe në fshatrat e tjera të Zadrinës, shkoi për t’u kuruar në Itali. Pata fatin t’i bëja një vizitë një javore në janar të vitit 2011 në Seminarin e Avezanos ku ai po qëndronte. Përjetova me të vërtetë ditët e mrekullueshme me të.

Dukej qartë se ishte i dashuruar me Shqipërinë. Që në fillim të ushtrimit të misionit të tij në Zadrinë ai publikoi librin me titullin kaq domethënës: Të kam ëndërruar Shqipëri.

Donte muzikën, liturgjinë, katekezat, rregullin. Don Antonio donte jetën.

Që ditën e parë që e kam njohur, ai është bërë për mua një model frymëzues për jetën. Shembulli i tij heroik, që e dha në mesin e popullit tonë në një periudhë delikate historike, do të jetë frymëzim për të gjithë ata/o që e kanë njohur.

Duke menduar për figurën e don Antonio Sciarra, më bien ndër mend fjalët e Jezusit ndërsa shihte turmën e popullit që ishte e nëpërkëmbur dhe e lënë pasdore si delet pa bari:

“Të korrat janë të mëdha, kurse punëtorë ka pak. Lutjuni, pra Zotërisë së të korrave, të dërgojë korrtarë në të korrat e veta”. (Mt. 9, 37-38).

Nikolin Sh. Lëmezhi



# HIMNI KOMBËTAR I SHQIPTARËVE



E njoha për herë të parë dr. Valbona Karakaçi kur e dëgjova në TV “Top Channel”, me Ardi Krastën, datë 29 nëntor 2009, ditën e çlirimit të atdheut nga pushtuesit nazi-fashistë dhe si me magji ndjeva një respekt të veçantë.

Studimi monografik “Himni kombëtar i shqiptarëve”, është një vepër madhore, e para e këtij lloji, rezultante e një pune të shkëlqyer, që nga prehistoria e himneve të popujve evropian dhe deri në ditët e sotme. Studiuesja pasionante, në pjesën e dytë të historishkrimit të “Himnit Kombëtar”, faqe 135 e librit, për autorin e këtij shkrimi dhe muzikantin e ndjerë kompozitorin e talentuar Ferdinand Lleshi, shkruan. “...Megjithatë, propozime për ndryshime ka pasur: më 1992 Komisioni i simboleve pranë Kuvendit Popullor hap debat të gjerë në popull. Korrespondenca, që gjendet sot në arkivat e Kuvendit ka një numër letrash, kryesisht të njerëzve të thjeshtë, të cilët, duke u nisur nga ftesa e Komisionit, ofrojnë kontributin e tyre. Me date 28. 4. 92 dëgjova se gjithkush mund të bëjë vërejtje për simbolet (letër e 11. 5. '92). Por në dosjen e Ligjit për Simbolet, depozituar në Kuvendin Popullor, gjendet vetëm një propozim konkret për himn të ri, me muzikë të Ferdinand Lleshit dhe tekst të Luigi Temalit: “Me rastin e diskutimit të simboleve në parlament mendojmë se do të ishte e njëanshme që diskutimi i tyre të mos përfshijë edhe himnin kombëtar, ku muzika është kompozuar nga një rumun dhe teksti paraqet një epokë (dhe jo plotësisht) deri në shpalljen e pavarësisë.

Himni i flamurit është simboli kryesor i kombit sepse ai i kushtohet vetëm flamurit, i cili është përfaqësuesi i vetëm dhe i përgjithshëm i gjithë popullit shqiptar në të gjithë botën. Mendojmë që ky propozim të diskutohet në parlament, duke parashikuar edhe krijimin e një konkursi për himnin e ri kombëtar.”

Në fund të vitit të kaluar autorja e librit u interesua të dinte diçka më tepër, prandaj shtroj pyetjen: “... kur, si e në ç’ rrethana të erdhi ideja dhe frymëzimi për

hartimin e tekstit?”

*Je burim i përparimit / Të gjithë kombin e bashkon / Nderi yt besa shqiptarit / Porsi Dielli kur agon.*

*O Flamuri Shqipërisë / Zemrat tona i gëzon / Të valëvit flladi lirisë / Drejt progresit na frymëzon.*

Në një emision televiziv për Artistin e Popullit, kompozitorin Preng Jakova, u nënvizua se: “Prenga në vitet e fundit të jetës paska qenë ngarkuar me detyrë për të bërë muzikën e himnit, por vdekja e parakohshme e ndaloj atë”. Gjithashtu mbi tavolinën e punës dukej një letër me një poezi për flamurin, por nuk u tha asnjë fjalë për përmbajtjen dhe autorin e saj.

Që nga ajo ditë një “pjesë” e mendjes për gjashtë vjet rresht është përpjekur, në një “lëvizje të pandërprerë”, për të gjetur frymëzimin për hartimin e tekstit të ri. Dhe momenti i kërkuar pas shumë viteve erdhi. Për kohëzgjatë me 28 Nëntor 1988 kur po kryeja detyrën e nëpunësit të shërbimit të rojës, papritmas në orën 21 e 30 minuta, në kohën e plotësimit të proces-verbalit të dorëzimit, si një dhuratë e zbritur nga qielli, erdhën fjalët e poezisë së shumëpritur.

Në një “telegram” të përdorur shkrova katër strofat e saj.

Flamuri, “Yll Polar” në ballë të luftërave për mbrojtjen e atdheut e të lirisë, vjen prej historisë së largët shumë shekullore drejt horizonteve pa kufi. Ai ka biografinë, dëshmorët, heronjtë dhe martirët e vetë, të cilët me jetën, veprën e gjakun e tyre i dhanë forcë, shkëlqim e lavdi. Emblema më e shkëlqyer e heroizmit masiv popullor në betejat legjendare 25 vjeçare, urtësisë, trimërisë, bashkimit të trojeve Arbëreshe dhe e orientimit Euro-Perëndimor është Heroi ynë Kombëtar Gjergj Kastrioti, Skënderbeu. “Pas errësirës qielli ndriti” d.m.th. pas sundimit 500 vjeçar otoman lindi dielli i lirisë dhe i pavarësisë me 28 Nëntor 1912. Ngritja e Flamurit në Vlorë u bë një gëzim i madh popullor, që lumturoj çdo zemër shqiptari. Ajo ishte një dritë e fuqishme që lindi në agimin e një ditë të re, epoke të re dhe e një jete të re e të pavarur.

Besa, burim i pashtershëm frymëzimi, tipar i burrërisë, i karaktereve të forta, katalizator i ekuilibrave të jetës. Ajo na ushqen me urtësi, forcë e siguri, por edhe me vetëpërmbajtje e guxim deri në vetëmohim për të mbrojtur nderin, dinjitetin, atdheun, lirinë, gjuhen shqipe dhe kulturën tonë të lashtë e të tjera. Strofa e katërt dhe e fundit ka nota të theksuara lirike, duke krijuar një ambient të gëzuar e festiv. Ajo ka krenarinë e ligjshme për të sotmen e aritur, optimizmin e të ardhmes dhe angazhimin mbarëpopullor në rrugën e gjatë e të vështirë drejt progresit pambarim.

Teksti dhe muzika përshkohet gjithashtu nga ndenja euro-atlantike e planetare, të dashurisë, humanizmit, mirëkuptimit dhe vëllazërimit në mes popujve. Kështu strofa e parë, e tretë dhe e katërt tingëllojnë natyrshëm edhe si fjalë e melodi shpirtërore e vendeve të tjera. P.sh. aty ku

thuhet: “O Flamuri i Shqipërisë.....”, një italian mund të thotë: “O flamuri i Italisë zemrat tona i gëzon, të valëvit flladi lirisë drejt progresit na frymëzon.”

Në faqen 105, kapitulli i 2-të “Historishkrimi i Himnit Kombëtar Shqiptar” lexojmë: “Ende është e paqartë se si atdhetarët që udhëhoqën lëvizjen për pavarësi vendosen që të njohin si Himn Kombëtar poezinë e shqipëruar e përshtatur nga Asdreni me muzikë të kompozitorit rumun Ciprian Porumbescu (1853-1883). Fakti që as teksti e aq më tepër muzika e kësaj vepre nuk janë pastërtish shqiptare i bashkohet edhe qëllimit, për të cilin u krijuar kënga, me funksion të ndryshëm nga ai i simbolit kombëtar...” Shkrimtarja e shquar dhe vizionare nëpërmes fakteve, dokumenteve, referencave historiko-shkencore, analizës e konkluzioneve respektive në përcaktimin e vlerave ideo-artistike të disa teksteve me autorë anëtarë të shquar të elitës intelektuale shqiptare, veçanërisht të gjysmës së parë të shekullit të kaluar, të cilët me përkushtim vendosen secili nga një gur në kështjellën e qëndrës së shekullore të himnit të Flamurit Kombëtar, bën “apel” për të ardhmen e tij. Në horizont duket një dritë jeshile. ....! “Ai që e ka gjetur gjithnjë rrugën e mbijetesës ka qenë popullit shqiptar e në mbijetesë e sipër është përpjekur të frytëzoj shtetin e vet.

Një prej formave të përfaqësimit të këtij shtetit janë edhe simbolet kombëtare, që për arsye të identitetit e të tharmit tonë kombëtar nuk mjafton vetëm të institucionalizohen, por duhet edhe të hulumtohen me argumente shkencor e fakte historike në mënyrë që e ardhmja jonë në një bashkësi më të madh të mos ngrihet mbi “pishmanet” e së shkuar, por mbi bindjen se një e shkuar e qartë i shërben një të ardhmeje më të mirë.”

Për zgjidhjen e kësaj “enigme” na ndihmon si kurdoherë mendja e ndritur e profesorit të ndjerë muzikologut të shquar Ramadan Sokoli, i cili në përfundim të artikullit të tij “Rreth gjenezës së Hymnit të Flamurit”, botuar në gazetën Drita, me 24 Maj 1992 shkruan: “... Urojmë që botimi i këtij shkrimi të shërbejë si nxitje për një himn të ri të kalitur në kudhrën e zjarrit e të përvojës sonë, që të jetë zëri kushtrimor i zemrës së popullit tonë e të përshkohet nga afshi i kësaj zemre të madhe, shkurt, të jetë i gatuar me intonacione kombëtare, që të prekë ndjenjat e dëgjuesve shqiptarë”. Profesor Sokoli, dy vjet para vdekjes, shprehu përsëri bindjen e tij të thellë që: “... një ditë himni patjetër duhet të ndryshojë. Çdo himn kombëtar duhet të jetë origjinal, të jetë i lidhur me kombin. Nuk duhen mohuar vlerat e himnit aktual. Shumë njerëz prej tij janë frymëzuar, e kanë kënduar ndërsa jepnin jetën për liri”. Teksti i himnit kombëtar “Rreth Flamurit të Përbashkuar” është i niveleve dhe kontributeve të spikatura. “Kush është burrë nuk frikësohet / Por vdes po vdes si një dëshmor”. Këto dy vargje së bashku me strofën e parë janë pjesa më thelbësore e poezisë. Por, për fat të keq, konstatohen edhe mangësi ideore, gjuhësore

dhe artistike. Poezia e Asdrenit u “hartua” para dhe në vitet e para të shpalljes së pavarësisë. “Të gjithë atje duke u betuar / Të lidhin besën për shpëtim”. Atdheu ndodhej nën kthetrat e grahamave të fundit të agonisë së te “Sëmurit të Bosforit”. Konferenca e Ambasadorëve e fuqive të mëdha Londër 1913, si ujçer të tërbuar i grabitën Shqipërisë gjysmën e territorëve të saj në favor të shteteve shoviniste fqinjë. Për shqiptarët e viteve të para pas shpalljes së pavarësisë, Evropa simbolizonte shëmbëlltërinë më të shpërfytyruar të tradhtisë së trashëguar. “Prej lufte veç ay largohet / Që është lindur tradhëtor!” Stërgjyshërit tonë u prenë në besë dhe u goditen nga të gjitha anët. Ishin kohë të vështira të ngarkuara me re, rrebeshe e stuhira. Por edhe ne, jo vetëm një herë me ose pa dashje, u sollëm keq dhe i mbetëm në qafë njeri tjetrit! Gjithsesi kohët kanë ndryshuar. Jemi një shekull larg shpalljes së pavarësisë dhe përsëri vazhdojmë të “lindim” armiq e tradhtar! Si është e mundur që njeriu sapo vjen në jetë, foshnjë, të “damkoset” me fjalën më të urryer në kuptimin më të keq spekulativ të absurditetit absolut të saj?

“Në dorë armët do t’i mbajmë / të mbrojmë - atdheun në çdo kënd / Të drejtat tona ne s’i ndajmë / Këtu armiqtë s’kanë vend”. Mbrojtja e atdheut ka qenë është e do të jetë edhe për shumë kohë detyra më e rëndësishme dhe e shenjtë. Kjo strofë na kujton luftërat heroike për liri e pavarësi të çetave patriotike të Ded Gjo Lulit, Mehmet Shpendit, Çerçiz Topullit, Mihail Gramenos, Isa Boletinit, Bajram Currit e të tjerëve, atëherë kur Shqipëria ndodhej në udhëkryqet e historisë. Por, “Himni i Flamurit tone (Në dorë armët do t’i mbajmë të mbrojmë atdheun në çdo kënd), L. 3 fq. 52. Vjersha të tilla mund t’i shkonin Enverit, që mësohej fshehurazi në kohë të Turqisë, por jo Shqipërisë dhe Evropës të viteve 2000.” A. K. Shekulli date 9. 9. 02

“Se Zoti vetë e tha me gojë / Që kombe shuhen përmbi dhe / Po Shqipëria do të rrojë? Për të, për të luftojmë ne”. Ky është betimi solemn i patriotëve të Bukureshtit e më gjerë në vitet, para dhe pas Shpalljes së Pavarësisë. Natyrisht një obligim i shkëlqyer. Gjithashtu, një paradoks i madh! Si është e mundur të vijojmë t’i këndojmë një “absurdi” sipas të cilit paskemi zbuluar sekretet e Krijuesit që disa kombe, ndër ata edhe Shqipëria, do të rrojnë ndërsa të tjerët duhet të shuhen! Këto fjalë siç paraqiten në këtë formë e përmbajtje nuk figurojnë askund në librat e shenjtë.

Dimensionet e Atit edhe pas qindramijëra miliarda vitesh janë të pa-arritshme nga çdo qenie inteligjente e Universit. E dyta, nga “besimtarë” të rrëmbyer prej “lojës” së fjalëve, pa dashje konvertohem në “ateistë”. Harrojmë dy vargjet e para, faktorin vendimtar të ekzistencës, i cili ndodhet shumë larg dhe afër nesh, përtej largësive të pafundme.

**Nga Luigj Temali, poet**

# Gjekë Toma “Mjeshtri duar artë”

Misioni më i shenjtë i njeriut në jetë është ta jetoj jetën me bekime të cilat Zoti ja fal. Përballë këtyre bekimeve njeriu duhet të jetë Mjeshtër për ti pranuar në jetën e tij dhe me i shumëfishuar. E kështu je mire me Zotin, e mirë me robin.

Në Lekaj të Shalës, përbri rrugës që të çon në Qafën e Agrit, votra e Tome Mark Çunit. Bekimet e Zotit, fisnikërinë e bujarinë i bashkëndau me çdo rrugëtar e të vobektë. Besa e lypur në këtë shtëpi gjithmonë u mbrojt deri në fund. Tome Marku shumë ngatërresave mes bashkëndësve, me urti dhe këmbëngulje u dha zgjidhje me pajtim. E kish fal Zoti për paqe dhe mirësi.

Sa herë u dha jehona e betejave për mbrojtjen e trojeve edhe pse në moshë të re u rreshtua përkrah Mehmet Shpendit e Abdi Kolës.

Muaji Maj, muaji i luleve në vitin 1945 e zbukuroj këtë vatër me një filiz të ri Gjekën, i cili do rritej me aromën e luleve dhe cicërimat e zogjve. Gjeka nga baba Tome dhe nana Linë bashkë në bukën, u ushqye me shembullin e mirë të tyre. Gjeka me zemrën e mbushur plot bekime, holli shtat në bjeshkët e bukura e në gurgullimën e gurrës.

Shumë shpejt që në rini ai u dallua për talentin e tij prej artisti ku u aktivizua me grupin artistik të Shalës dhe u përzgjedh për të dhënë koncert në Teatrin “Migjeni” së bashku me artistët më të mirë të folklorit. Pas shfaqjes ai u përzgjedh nga specialistet e folklorit të studionte në Tiranë në një kurs 6 mujor.

Në moshën 20 vjeçare, ai si shumë djem të Dukagjinit fillon një jetë të re nëpër veprat e kohës si në Fierzë, Elbasan, Koman e të tjera.

Krahas talentit si instrumentist virtuoz në çifteli dhe gjethe. Gjeka ishte novator edhe në mekanikë ku nga duart e tij të arta montoheshin shumë mjete motorike si traktor dhe pjesë këmbimi të makinerive të rënda që nevojiteshin për ndërtimin e digave gjigante. Pikërisht për këto merita Kuvendi Popullor do ta dekoroj me titullin “Mjeshtri duar artë”.

Në vitin 1971, Gjeka përsëri do të përzgjidhet të udhëtoj së bashku me orkestrën e Radio Televizorit Shqiptarë për një turne në Rumani, ku do të interpretonte një Suit me gjethe e çiftelie dhe orkestër. Kështu Gjeka u bë i pari dhe i fundit (deri tani) instrumentist popullor që harmonizoj me mjeshtri tingujt e çiftelisë dhe gjethe me një orkestër simfonike. Publiku Rumun e duartrokiti gjatë për mjeshterin e interpretimit në dy instrumente ku njiheshin shumë pak prej tyre.

Sukseset ndjekin njëra -tjetrin e kështu edhe në vitin 1977 në turne e Ansambllit Kombëtarë në France. Gjeka interpretoi me gjethe ku duartrokitet e shoqëruar gjatë.

Gjekën fati e çoj në një tjetër fis artistash, në Dakaj të Shalës në derën Fran Vat Lucës. Me harmoni bashkëshortore ata mbollën mirë dhe korren mire, siç e thotë një fjala e vjetër. I rriten dhe edukuan fëmijët e tyre me nderim ndaj Zotit dhe dashuri për jetën dhe punën. Edhe

pse emigrimi i shpërndau folësen e tyre në emigrim ata qëndruan dhe qëndrojnë gjithmonë së bashku.



Në vitet e demokracisë Gjeka u vendos familjarisht në Balldre dhe aktivizohet me grupin folklorit të Lezhës në shumë veprimtari u vlerësua me çmime të ndryshme.

Gjeka kishte lindur artist në shpirt.



Ai me artin e tij i jepte jetë dhe tinguj drurit dhe hekurit. Ai do punonte shumë instrumente popullore e deri tek violina.



Shumë artist të talentuar zgjodhën që instrumentet e tyre të ishin të punuara nga Gjeka. Kjo bëri që ai në Festalet Folklorike të Gjirokastrës të merrte pjesë si instrumentist dhe si mjeshtër i instrumenteve.

Me artistët ai miqësinë e kishte të shenjtë dhe e vlerësonte shumë. Mjeshtri i Madh dhe i papërsëritshëm Ndue Shyti

në shumë evenimente kërkonte që Gjekën ta kishte përkrah. Interpretimin së bashku melodi të ndryshme dhe bisedonin për instrumentet që ato të ishin sa me të arrira artistikisht.

Pas një pranverë të bukur të shijuar në gjirin familjarë në muajin Gusht të vitit 2022, Gjeka ndërroj jetë. Në pikëllimi për largimin e tij nga mesi jonë, ne gjejmë ngushëllim në emrin dhe shembullin e mire që la pas. Ai nderohet dhe respektohet sepse me ndihmën e Zotit ai gdhendi në librin e jetës mërinë e burrit fisnik dhe Mjeshtër Duar Arte.

Gjeke Toma që tashmë je bashkuar korrit të engjëjve në Parajsë me Krishtin!

Faleminderit që me jetën tënde nderove vetën, familjen dhe krejt Dukagjin!

## Opinione:

**Kantautori Fran Kodra**, Artisti Gjekë Toma ishte miku i jonë ma i mirë. Instrumentisti i parë dukagjinasi i përmasave Kombëtare. Ai kishte shpirt novatori dhe mjeshtër i gdhendjes i të gjitha llojeve të instrumenteve tradicional si sharki, çifteli, fyell, bilbil, violinë, Kitare e tjerë. Ne, ruajmë kujtime dhe mësim të paharrueshme për këtë mjeshtër të folklorit dhe traditës, që do t’jetë gjithmonë në zemrat tona si njeriu talent i skalitur me të gjitha virtytet e larta të një Malësori, një mjeshtri dha artisti të pazëvendësueshëm, duke e ndier gjithmonë mungesën e tij.

Pushofsh në paqe o miku i jonë i sh-trenjtë!

**Poeti Lulash Ara**, kam pasur fatin ta njohë nga afër, në HC/ Koman. Një instrumentist i shkëlqyer. Shpirti i tij pushoftë në paqe!

**Këngëtari Ikli Punavija**, Nëse Institucioni i Presidencës nuk e ka dekoruar “Mjeshtër i Madh”, patjetër i takon ky titull!

Roza Pjetri

# Lavdia dhe huta e lanë emrin tek lahuta



Shkruar nga Profesori Gjon Frani Ivezaj, New York, Nëntor 2022

Në viset e veriut, atje ku Kullat e gurit merrnin dhe japnin jetë mes malesh mbizotëronte men-

çuria dhe trimëria të cilat i jepnin identitetin Kullës, Malit, Krahinës dhe këngës në të cilën lartësohej njeriu i veshur me virtytet më të larta fisnore për të merituar dhe lartësuar emrin "Malësor".

Andej nga vij unë, në viset e Grudës Kreshnike, kullat e vjetra të gurit ishin të shpërndara ndër bregoret rrexë kodrave, shumica prej të cilave me pamje nga dielli, të mbushura me dritë e me frymë jete si për të dëshmuar atë ndërldhjen e përhershme që malësorët kishin me nënën natyrë.

Megjithatë për të mbijetuar në këto kreshta të ashpra ku dimri dhe armiku "flinin mbas dere" siç thoshin të vjetrit, kullat vigjilonin gjatë gjithë kohës për të mbrojtur veten dhe bijtë e saj. Ndaj, në ballë të vatrës dhe oxhakut qëndronte gjithmonë e varur një HUTË, e përkrah saj një LAVDË e moçme e cila kalonte dorë më dorë në netët e gjata që tingujt e saj të mbanin gjallë frymën e shpresës e të qëndresës së bijve të asaj kulle.

Në kuvendet e atëhershme Lavdi dhe Huta shpesh emëroheshin "rojset e oxhakut", njëra për t'ia mbrojtur nderin e kullës dhe tjetra për ta dëshmuar e lartësuar në këngë nderin e bijve të saj. Ky dualitet vlerash simotra, pa një të dhënë ekzakte për hershmërinë dhe zanafillën e saj por me një version të qartë të trashëgimisë gojore erdhën dhe u unifikuan në një të vetme, duke ba që në rrjedhën e shekujve, LAVDA dhe HUTA ta lanë dhe mishërojnë emrin tek LAHUTA".



Kjo hipotezë shkencore e rrallë në llojin e saj do na mjaftonte për të pasur një peshë përgjegjësie më të madhe jo vetëm institucionale por edhe individuale, pasi njeriu i shekullit të ri gjithnjë e më pak po ruan këto lidhje të gjalla të identitetit fisnor dhe racor nga e ka prejardhjen. Sot numërohen me gishtat e dorës lahutarët jo vetëm në Grudë por në krejt trojet etnike gjë që e bën akoma më të zhvlerësuar këtë trashëgimi të gjallë kulturore me vlera të jashtëzakonshme për identitetin tonë kombëtar.

Ajo që më nxiti së tepërmi të shkruaj dhe të cekim këtë temë kaq delikate por me vlera të larta kulturore e shpirtërore, janë disa aktivitete që u bënë kohët e fundit në Shqipëri dhe Kosovë ku spikati "Takim me lahutarët shqipfolës" në Malësi të Madhe. 10 Lahutarë, shumë prej të cilëve pleq të moshës së katërt, ndër ta edhe një grua me xhubletë.

## RAPORTOJENI KËTË REKLAMË

Me keqardhje e them se sot kemi kaluar në regres të rëndë kulturor dhe kemi rënë në amatorizëm të shfrenuar, ku ajo që vërehet më së shumti dhe që e bën akoma më të rrezikuar ekzistencën e Lahutës në të ardhmen veç mungesës së kritikëve, është pa dija mbi identitetin e lahutarit, i gjinisë mashkullore ose në raste tejet të rralla i burrneshës me çakçirë e cila mbart imunitetin e një burri në kuvende dhe jo të një gruajë me xhubletë e cila rreshtohet me lahutarë të mirëfilltë në të tilla skena.

Duhet kuptuar se Lahutari ka gëzuar gjithnjë vend nderi në treveza e kuvende. Atij i lihej vendi në ballë të oxhakut pasi veç këngës dhe interpretimit lahutari kishte edhe një tjetër mision. I gjendur në brendësi të kuvendit ai duhej të merrte edhe fabulën e këngës, të mësonte me imtësi ngjarjen, të dëgjonte mbi qëndresën dhe detajet të cilat do t'i kthente në vargje dhe do t'i thurte për këngë lavde, krye-

sisht epike.

Lahutarët njihen edhe shkencërisht si përçuesit e historisë të cilët edhe pse nuk dinin shkrim e këndim ata kishin një tjetër betim mbi lahutë, për të dëshmuar me vërtetësi realitetin në kohë e në hapësirë, ndaj edhe ky instrument ishte i përcaktuar vetëm për burrat. Lahutarët e trashëgonin këtë profesion në familje dhe e perfektiononin në dasma, në kuvende e në logje ku bëhej edhe interpretimi i lahutarëve më me za.

Instrumentin e punonte vetë lahutari, pasi e kishin përvetësuar teknikën e punës nga baba apo një tjetër pjesëtar i familjes. Të rinjtë për ta mësuar këndonin në duet me lahutarët e vjetër të kullës derisa u piquej zani dhe fitonin disa tipare burrnice. Mbasi lihej kënga lavde gjithmonë duhej të varej në të majtë të oxhakut për tu tha, pasi materiali shtazor me të cilin punohej, për të prodhuar tingull të mirë duhej të ishte "arrë e thatë" thoshin të vjetrit.

Ky ritual bëhej gjithmonë me një fanatizëm të skalitur tek secili anëtar i kullës ndaj edhe lavde ishte e paprekshme njësoj si huta. Lavdi i gdhendur me simbolin e përkrenares apo ato të kultit, së bashku me rasën e saj, varej në ballë të oxhakut, në krah të Hutës e cila qëndronte e heshur dhe hijerëndë.

Të dy këto roje të oxhakut, përkëdheleshin herë nga rrezet e diellit që hynin nga dritoret e vogla të kullës e herë nga tymi i kandilit të oxhakut dhe çibukut të plakut rrëzë tij. E kështu jeta vazhdonte udhën e saj nëpër shtigjet e mot moteve, e kulla qëndronte e mbijetonte duke pritur e përcjellë brezat në përjetësi e nuk reshte kurrë së dëshmuari, se

Lavdi dhe Huta mbeten krenaria e KULLËS së Malësorit.

## Ndahet nga jeta emigranti i pare shqiptar Pjeter Kukaj

Ndahet nga jeta emigranti i pare shqiptar Pjeter Kukaj, i cili kishte shkëlur në token e Belgjikës në vitin 1956.

Pjeter Kukaj, i cili ndërroi jete këto ditë, në moshën 97 vjeçare, ishte dhe refugjati i pare që kishte mbërritur në token e Belgjikës. në vitin 1956.

Pjeter Mark Kukaj, lindi në fshatin Raje, në krahinën e Mërturit, me 25 shtator 1925. Babai i 8 fëmijëve e gjyshi i shumë nipave e mbesave. Vinte nga një familje e nderuar, ku kalvari i mundimeve nis që në fëmijërinë e tij, me vrasjen e babait të tij në Malësinë e Gjakovës.

Në muajin korrik të vitit 1952, ai largohet për në Jugosllavi. Pas qëndrimit në kampin e Geroves, komisioni shumë palësh i OKB-së e dërgon në Belgjikë.

Pritja bujare e shtetit belg ishte e madhe, për të siguruar punë e shtëpi. Kështu do të integrohej në jetën e Belgjikës, por pa harruar asnjë çast vendin ku kishte lindur. Gjate jetës së tij punoi shumë për

rritjen dhe edukimin e fëmijëve.


Ai ishte një shembull për pajtimin e grupeve politike shqiptare dhe mbrojtjes e të drejtave të Kosovës. Gjithashtu, ai ishte aktiv në jetën politike shqiptare i radhitur në pjesën e Bllokut Kombëtar Antikomunist.

Pjetri për një muaj humbi dhe bashkëshorten Dranden, që kishin jetuar bashkë për 67 vite, duke lanë një familje të madhe dhe me tradita të mëdha.

Pjetri, është përcjellë me nderime të mëdha nga bashkësia shqiptare, i ardhur nga të gjitha qytetet e Belgjikës në meshën e shenjte, në Kishën Saint Servais Schaerbeek.

Trupi i pajete do të pushoje në varrezat Ever. Pushoftë në paqe! Ngushëllime familjes dhe të afërmeve!

Përgatiti  
Zef Nika, Bruksel



# Poeti Luigj Temali

Luigj Temali lindi me 23 Janar 1941 në Shkodër, fëmija i parë i Zef Temalit dhe Marije Ndrekes. I ati, Zef Temali i lindur në Shkodër, ishte me prejardhje nga fshati Telum i krahinës Temal, ndërsa nana nga fshati Pog, i krahinës së Pultit.

Luigji kreu shkollën 7 vjeçare "Ndoc Mazi", në vitet 1948-1955, ndërsa shkollën e mesme në gjimnazin "29-28 Nëntori", në vitet 1956-1958.

Pasi mbaroi shkollën e mesme, ai kreu detyrën ushtar shofer i gatishmërisë së Repartit ushtarak 1105 në vitet 1961-1962.

Më vonë punoi punëtor në ndërmarrjet Nil-Prodhome, fabrika e Tullave, Ndërmarrja komunale banesa, Kooperativa Artizanat-Veshmbathje në vitet 1963-1966.

Student i Fakultetit Ekonomik në, Universitetin Shtetëror të Tiranës, dega Financë, në vitet 1966-1970. Në vitet 1973-1975 përfundoi studimet e larta në degën e filozofisë.

Mbas studimeve të larta punoi ekonomist financiar në Ndërmarrje Peshkimit, Kombinati i Drurit, janar 1973-1975. Me pas financier në Ministrinë e Financave në vitet 1970-1972.

Ka ushtruar detyrën e shefit të llogarisë për 25 vjet në Telekom Shqiptar, Shkodër në vitet 1976-2001.

Luigji, poeti i ardhshëm, në fillim filloi të merret me publicistike. Po theksojmë artikullin e parë: "Banorët e Cukalit", botuar në tetor 1973 në gazetën "Zëri I Popullit", kur ishte revizor i Kombinatis të Drurit Shkodër, që ja kushtoi trimave të Dukagjinit legjendar, që ishin njerëz të mrekullueshëm, të cilët punonin e jetonin në kushtet e një dimri shumë të ashpër, të një natyre të egër, por madhështore dhe jashtëzakonisht të bukur. Gjithashtu ja kushtoi veçanërisht njeriut të mirë, punëtor e të guximshëm, djaloshtit të ri dhe trim Nike Pëllumbi, i cili pak vite më vonë vdiq aksidentalisht në krye të detyrës.

Luigji, më 1997 botoi vëllimin e parë "Për ty", në të cilin përfshihet dhe poezia "Flamuri Ynë", si propozim për himn të ri me muzikë të Ferdinand Lleshit.

Më tej krijimtaria e Luigjit vijon me librat:

Një dritare nga jeta- 1998,

Gjurma -2001

Lule nën një shkëmb 2001

Buzëqeshja e Yjeve- 2010

Veprimtaria e tij letrare përfshin më shumë se 350 artikuj të botuar në gazeta dhe revista të ndryshme si "Drita", "Telegraf", "Shqipëria Etnike", "Sot", "Dukagjini", revista "Muzgu", revista "Fjala" (Koplik), ndër të cilat mund të përmendim:

Pse ne dhe universi ekzistojmë  
Mbi Evropën e Bashkuar

Gjergj Kastrioti Skënderbeu është hero legjendar, jo personazh tragjik sipas Schmitt

Edhe kafshët kanë shpirt  
Cili jeni ju zoti Djall  
Retë nukleare po mbulojnë planetin  
Qytetërimet jashtëtokësore

Legjenda e yjeve

Ç' katastrofë për njerëzimin paraqet  
Samiti i Kiotos

Përtej thellësive të shpirtit

Luigji ka bërë përpjekje të merret me Himnin e Flamurit, për të ndryshuar pak tekstin e tij. Për këtë Doktor Valbona Karakaçi, në librin e saj "Himni Kombëtar i Shqiptarëve", faqe 135 shkruan në

mes të tjerave si vijon: "Por në dosjen e ligjit për simbolet depozituar në Kuvendin popullor gjendet vetëm një propozim konkret për himn të ri, me muzikë të Ferdinand Lleshit dhe tekst të Luigj Temalit. Në faqet e librit Nr. 226-227 gjendet teksti dhe muzika për himnin e ri kombëtar:



Marije e Luigj Temali



Prindërit e Luigj Temalit,  
Marija e Zef Temali



Luigji me nënën e tij, Marijen

Himni i Flamurit

Larg në shekuj në histori  
Përmes luftës burrërore  
yll polar të patëm ty  
dhe do t' kemi n' çdo fitore.

Ke shqiponjën e Kastriotit  
Kur t' shpalosi në at, nëntor,  
Pas errësirës qielli ndriti  
lumë drite solle në Vlorë.

Je burim i përparimit  
të gjithë kombin e bashkon,  
nderi yt besa e shqiptarit  
porsi dielli kur agon.

O flamur i Shqipërisë  
zemrat tona i gëzon,  
të valëvit fladi i lirisë  
drejt progresit na frymëzon.

Poeti Luigj Temali, ka pasur korrespondencë me 2 papët e Vatikanit, Papa Gjon Pali II dhe Papa Benedikti i XVI, për "Himni i Evropës", "In particolare il testo dell'inno all'Europa" botuar në librat "Për ty", "Një dritare nga jeta", "Gjurma" e të tjera.

Luigji është i martuar me Marije Temali dhe ka dy vajza: Albana doktore e shkencave në Biologji dhe Irma me profesion arkitekte.

**Ndue Sanaj  
e Irma Temli**

# Personalitet i Flotës Detare Luftarake

## MARK TOM PLANI



Komandant MARK TOM PLANI lindi më 14 prill 1925 në qytetin e Shkodrës. Rrjedh nga një familje me origjinë punëtorë dhe atdhedashëse.

Babai i tij Toma, i lindur në fshatin Plan të krahinës së Pultit-Dukagjin, ka qenë bashkëluftëtar me Ded Gjon Lulin.

Komandant Mark Tome Plani përqafoj lëvizjen antifashiste dhe në vitet 1942-43 u aktivizua me rininë antifashiste.

Në tetor 1944 shkoi partizan në grupin e Shkodrës dhe në Nëntor -Prill 1944 në brigadën e XXVII -S.

Për meritat e tij në luftë, bashkë me disa partizanë të tjerë u dërgua për studime në ish- BS.

Në vitin 1945 deri 1949 vijoi dhe mbaroi shkollën e lartë të Marinës në Baku të Azerbajxhanit.

Për rezultate të larta të arritura në Akademinë e Azerbajxhanit, bashkë me dy shokë të tjerë u dërgua për të vijuar studimet në Akademinë e Detarisë në Leningrad.

Akademinë e filloi në vitin 1949 dhe e përfundoi në vitin 1952, me rezultate të larta. Komanda e Akademisë së Leningradit e vlerësoi si një nga djemtë më të zotë, të mirë të brezit të tij.

Me mbarimin e Akademisë shërbeu në Flotë me detyra të ndryshme, komandant flotilje e deri Shef Shtabi I FLD-së.

Komandant MARK PLANI drejtoi për më shumë se 18 vjet njësi taktike operative si Flotilje Brigade duke qenë drejtues kryesor për disa vjet në Flotë.

Nuk ishte rastësi, që Komandant MARK PLANI drejtoi këtë njësi kaq të rëndësishme. Ishin aftësitë e tija profesionale, komunikimi i tij i mirë me vartësit, me koleget e eprorët, por dhe aftësitë e tij organizative e drejtuese.

Më 3 Tetor të vitit 1960, në bazë të urdhrin të Ministrisë së Mbrojtjes Popullore, nr. 083, datë 23. 02. 1960, krijohet Komisioni i komandës së Flotës Luftarake Detare, me kryesues të tij kapitenin e rangut dytë MARK PLANI (Shef Shtabi i FLD) për marrjen në dorëzim për lundrim të vetmuar nga ekuipazhet shqiptare të nëndetësve me nr. 270, 290, 284, 296 dhe të bazës lundruese "Tomorri".

I aftë të njihje vartësit, të caktonte

detyra, të organizonte e të drejtonte ata, ku të merrte rendimentin maksimal të punës. Shtabnik i mirëfilltë, i veçantë në vlerësimin e situatave dhe në marrjen e vendimeve.

Në situata të veçanta, të vështira ku në njësi kishte ngjarje ka ditur të mbajë dinjitetin e tij e të vartësve, duke i mbrojtur me përgjegjësi detyrat e tyre.

Meritë të veçantë ka në përpilimin e dokumenteve luftarake, për ruajtjen e mbrojtjen e bregdetit, po kështu në përpilimin e dokumenteve jetike për gatishmërinë e stërvitjen si rregulloren e poligoneve, të shërbimit të Radarëve e të tjera.

Marku ishte një oficer i mbajtur, modeli në pamjen e jashtësme, fizike, i dashur me shokët, njeri shumë i komunikueshëm, shumë i kulturuar, i edukuar, aktiv në biseda për artin, me horizont të gjerë për artin, kulturën, muzikën e sportin.

Komandant Mark Plani punonte ditë e natë për forcimin e Flotës dhe me dijet e tij në çështjet detare ai pyetej për shumë problem teorike dhe praktike, për të cilat ka shkruar shumë artikuj shkencorë në shtypin ushtarak të kohës.



Një kontribut të padiskutueshëm dhe të pazëvendësueshëm Komandant MARK PLANI ka dhënë në kohën kur qeveria



jonë hyri në konflikt me BS, për të përballuar atë situatë tepër të acaruar, për të evituar ndonjë konflikt të armatosur mes forcave tona dhe atyre sovjetike, që do të ishte me pasoja të paparashikuara për vendin tonë. U krijua Shtabi Operativ, Komandant Admiral (gjenral lejtant) HITO ÇAKO, ndërsa Komandant MARK PLANI, Nënadmirali, Shef Shtabi i këtij grupi dhe Shef Shtabi i Forcave Detare Shqiptare.

Në këtë detyrë Komandant MARK PLANI, ka shkëlqyer, duke treguar aftësitë e tij akademike të larta.

Komandant Mark Plani ishte në përbërje të komisionit qeveritar Shqiptaro-Sovjetik, të cilët do të vendosnin se si do të ndaheshin mjetet luftarake mes nesh dhe sovjetikëve dhe se si kjo situatë kaq e rëndësishme të kalohej pa konflikt të armatosur. Mendimet dhe qëndrimet profesionale të Komandant Mark Planit, kane qenë bazë për vendimmarrje nga komisioni. Ajo kohë ka qenë një situatë heroike, siç është parë edhe në opinionin shqiptarë, nëpërmjet filmit Ballë për Ballë.

Për atë kohë e situatë, për punën e

Horizonti i tij i gjerë, kultura e tij, aftësitë e tij profesionale spikatën më mirë, kur u caktua si pedagog në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm "Mehmet Shehu", në të cilin koleget e tij e dëgjonin me shumë respekt, mbasi kishin çfarë të merrnin prej tij.

Shokët e tij, të brezave që kanë punuar me Komandant Markun dhe atyre që shërbejnë sot në Flotë, e kujtojnë me shumë respekt komandantin e tyre të dashur e të mirë.

Puna dhe vepra e tij në Flotë e bëjnë ta respektojnë Komandant MARK PLANI si një personalitet i FLD.

MARK PLANI përfaqësonte oficerin, detarin e kompletuar, eposin e malësorit, të cilin gjithmonë e pohonte me krenari dhe Shkodranin e kulturuar.

Komandant MARK PLANI ishte dhe një familjarë i shkëlqyer.

Bashkëshortja e tij, Domenika, një katolike e vërtetë, e thjeshtë dhe shumë e ndershme, një nënë e mirë dhe e mrekullueshme.

Nga martesë me bashkëshorten Domenika, kishin 2 fëmijë të mrekullueshëm,



palodhur, heroike, të mençur, me besnikëri të jashtëzakonshme, merita i takonte Komandant MARK PLANIT.

djalit Sokoli dhe vajzën Elena.

Sokoli mbaroj studimet për Inxhinieri Mekanike, ndërsa Elena për Pedagogji.

Edhe Sokoli ndoqi rrugën e babait, duke punuar për 10 vite si K/Inxhinier i Anijes Tregtare "Tirana" (Flota Detare Tregtare). Më pas në detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm i Kantierit Detarë Drejtor i Përgjithshme kompanisë "Përparimi".

Elena ndoqi rrugën e mësuesisë.

Ndarja nga jeta para kohe e Komandant MARK PLANI, me 20 nëntor 1984, ishte humbje e madhe jo vetëm për familjen e tij të mrekullueshme, por humbje për FLD dhe për vendin.

Kuadro të tillë janë një aset, një kapital i çmuar për të gjithë brezat që do të vijnë.

Në Nëntor 2012, Presidenti i Republikës z. Alfred Moisiu, me rastin e 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë e dekoroi pas vdekjes, Komandant MARK PLANI, me urdhrin "Gjergj Kastrioti-Skeenderbeu".

**Ndue Sanaj e Sokol Plani**

# Kuriozitete

**Kush është shteti më i vogël në botë, me vetëm 47 banorë?!**

GAZETA SHQIP, 5 nëntor 2022

Ishujt Pitcairn (shih foto 1) janë një pikë e vogël në planet, konkretisht në Paqësor, midis Zelandës së Re dhe Perusë me vetëm 47 banorë. Së fundmi është vënë në qendër të vëmendjes pasi janë lejuar martesat e homoseksualëve. Edhe pse asnjë banor i ishullit nuk është homoseksual apo ndonjë çift tjetër homoseksual nuk ka shprehur interes për të shkruar atje për t'u martuar.

Pitcairn, i banuar për herë të parë në 1790, është një koloni britanike, por ka njëfarë autonomie ligjore dhe për këtë arsye konsiderohet si vendi më i vogël në botë për sa i përket popullsisë. Është një parajsë tokësore, e mbytur në gjelbërim dhe krejtësisht e sigurt pasi të gjithë banorët njihen me njëri-tjetrin dhe nuk i mbyllin kurrë shtëpitë. Të gjithë banorët janë pasardhës të drejtpërdrejtë të piratëve të rrëmbyer Baudu dhe Tahiti. Ishulli është jashtëzakonisht pak i populluar dhe ka vend për shumë të tjerë.

Ata që dëshirojnë të bëhen banorë të përhershëm dhe nuk kanë lidhje familjare me ishullin, ftohen të paraqesin një aplikim në Këshillin e Ishullit dhe Guvernatortit. Ishulli (shih foto 2), i cili bazohet financiarisht në turizëm, shpalli falimentimin në 2004 pasi pak njerëz e dinë për të dhe turizmi është në rënie. Energjia elektrike është shumë e shtrenjtë ndërkohë që popullsia e ishullit po plakët me shumicën e banorëve mbi 65 vjeç. Të rinjtë që duhet të shkojnë në shkollë të mesme shpërngulen në Zelandën e Re, ndërsa në përgjithësi fëmijët që jetojnë në Pitcairn janë të paktë. Së fundmi interesi i planetit ra në këtë pikë të Paqësorit pasi u miratua një ligj që lejon martesat e të njëjtit seks.

Meralda Warren, një banore 70-vjeçare, zakonisht thotë se asnjë martesë homoseksuale nuk ka ndodhur që nga miratimi i ligjit në ishull dhe beson se kjo nuk do të ndodhë kurrë. Madje ajo deklaroi se askush në ishull nuk ishte marrë me ngjarjen derisa ditët e fundit nisi të flitej nga mediat ndërkombëtare.

**20 sekrete suksesi nga mendimtarët më të mëdhenj të historisë**

GAZETA SHQIP, 7 nëntor 2022

1 – Si shumë prej nesh, Beethoven e fillonte ditën duke bërë kafe. Ai insistonte në përdorimin e 60 fasuleve për çdo filxhan.

2 – Benjamin Franklin flinte herët e zgjohej herët edhe në vitet e tij të fundit. Mëngjeset e tij konsistonin në lexim dhe shikim për rreth një orë brenda banjove me avull. Më pas vishej e shkonte në punë.

3 – Shumë shkrimtarë e artistë të famshëm siguroheshin të hanin mëngjes. Viktor Hygo preferonte vezët e ziera.

4 – Përpara se Frojdi të shkonte në zyrë, rruante mjekrën tek berberi i tij.

5 – Agatha Christie nuk kishte kurrë

një tavolinë. Ajo shkroi 80 novela, 19 drama dhe një numër veprash të shumta kudo që ulej.

6 – Ernest Heminguej shkruante në këmbë.

7 – Thomas Volfe gjithashtu shkruante në këmbë duke përdorur frigoriferin e tij si tavolinë pasi ishte 2 metra i gjatë.

8 – Disa e përdorin Starbucks vetëm për të pirë kafe, ndërsa Rainbow Rovell, autor i novelës "Elanor and Park" e shkruajti të gjithë librat e tyre në këtë zinxhir kafenesh.

9 – Richard Wright i ka shkruar të gjithë veprat e tij në stolin e parkut Fort Greene në Bruklin.

10 – Maya Angelou është e paaftë të shkruajë në mjedise të bukura. Ajo preferon të punojë në dhoma hotelesh e motelesh.

11 – Frank Lloyd Wright nuk punonte dot në presion. Ai nuk mund të punonte nëse nuk e kishte dizajnin e tërë në kokën e tij.

12 – Truman Capote tha për Paris Review: "Nuk mund të mendoj nëse nuk rri shtrirë". Të njëjtën gjë tha edhe Proust.

13 – Kur kompozitori Igor Stravinsky ndjehej i bllokuar, ai ulej me kokë poshtë për të qartësuar mendjen.

14 – Woody Allen futet në dush shumë herë në ditë kur ka nevojë për ide.

15 – Pianisti klasik Glenn Gould agjëronte në ditët që regjistronte muzikë. Ai mendonte se e bënte mendjen e tij më të mprehtë.

16 – Poeti gjerman Friedrich Schiller insistonte se era e mollëve të kalbura në sirtarin e tavolinës stimulonte krijimtari-në e tij.

17 – Shpeshherë, mjafton të fokusohesh. Shkrimtari Jonathan Franzen punonte në kompjuter duke vendosur tapa në vesh.

18 – Stephen King shkruan çdo ditë të vitit me një qëllim për të arritur 2000 fjalë




në ditë. I duhen 5 orë për ta bërë këtë.

19 – Duke filluar nga viti 1950, Vladimir Nabokov shkroi draftet e para për kartat e indeksit. Ai i korrigjon paragrafët

dhe kapituajt me një riorganizim të shpejtë.

20 – Kur Anthony Trollope përfundoi së shkruari një libër, ai filloi menjëherë një tjetër./Bota.al



# U shua një yll

Njëzete e tetë, nata e Tetori  
Natë trishtimit e ra një truallit  
Një terror i pa mëshirë  
Me plage të renda gjam e brime  
Po si ndodhi ktij pafati?  
N'mes të natës, fjetë te shtrati.  
I ra në zemër burrit infarkti  
Një trishtim i pa mendua  
Në prani me fëmijë e grua  
Atmosfera shumë e trishtua  
Njëzetë e nëntë dymijë e njëzet e dyshit  
Heshti maja e Muleqithit  
Ra mjegulla në fushën e Cukalit  
Vaj e lot fisi i Shllakut  
Ende drita mirë pa dal  
Telefonat radhe pa radhe  
Lajm të zi tu dhanë  
Në ato krahina anë në anë  
Thonë ka ra një vdekje e rende  
Një burrë fisit zemra e ka lanë  
Burrë kreshnik, ylli i Shllakut  
Bardhok Zhuri në Gegaj t' Shllakut  
Djali i Pjetrit, nipi i Gjon Marashit  
Familja burrnore, ndera e krahinës  
Dajati i pati burra vatanit  
Nike Mhill Niken në Vilë të Temalit  
Ngjarje e rende shpirtrat i goditi  
Pikëlloi familjen e tronditi fisin  
Fisi i Gegajve rriti burra  
I vlerësoi qëndresa, besa e kultura  
Rriti Gjekë Gegen trim e mendimtar  
Patriot e besnik shqiptar  
Mendimi i tij ishte ligji i vendit  
Anëtar në Lidhje të Prizrenit  
Bardhoku që kur ishte i ri  
U frymëzua me vlerat e tij  
Jeta i solli shumë përparësi  
Shpejt mori kulturë e burrni  
U vlerësua në mendime  
I ri në moshë, burrë në veprime  
U shkëput nga jeta e rinise

Para kohe në kuvend t' burrnisë  
E mbajtën afër, burrat e dëgjuan  
Shumë mendimet ia vlerësuan  
Me ato vlera zuni vend  
Në shoqëri e n' kuvend  
Për burrni u ba shembull  
Në ato krahina bani ëmën  
Në tranzicion, në demokraci  
Ju desh Shllakut dikush me pri  
Po i besojnë këtij djali të ri  
Ai për fisin qushesh krenari  
I vendosen emrin në kandidature  
Me unitet atë e votuan  
Ja dha populli me vullnet  
E përsëriten katër here rresht  
Me detyrë kryetar komune  
Me problem shumë të trazuan  
Në krahine burrnore, por varfërim  
Në plan të pare për ndryshim  
Ja caktoi vetes detyrim  
I ra krahinës anë në anë  
Shllak, Temal-Dushman e Toplane  
Shumë problem i solli jeta  
I shfrytëzoi aftësitë e veta  
Jeto hallet e kohës së vështirë  
Me përkushtim sa pat aftësi  
Shërbej me dëshirë e drejtësi  
Pa u kursye ditë as natë  
Pa dallim shoqnor apo partiak  
Ju vu punës me shpirt e ndërgjegje  
Me drejtësi e pa haterlleqe  
S' pranoi bakshishe apo rrushfete  
Për te ishte vetëm drejtësia  
Sinqeriteti e burrnia  
Ruajtja e parimeve me autoritet  
Fitoi besim e shumë respekt  
Kudo mbet burrë i nderuam  
Dhe pushteti e ka vlerësua  
Kur problemet krijuan parregullsi  
Nuk po i ecte dëshira e tij  
E s' po shihte përparim

Edhe shteti humbi interesim  
Me arsye e me dëshirë  
E vrau ndërgjegjia në detyre  
Kërkoj dorëheqje pa evokim  
U largua e bani dorëzim  
Largoi streset e detyrim  
Prej atij populli që e admiroi  
Por hallet s' mundi ua plotësoi  
Se vete shteti se ndihmoi  
Në jetë i doli një detyre e dytë  
Me m' kam shpin e me rrite fëmijët  
Mori vendimin si pa prite  
Udhëtoi emigrant në Amerike  
U nda me grua e fëmijët  
Me besim me u bashkua një ditë  
Pate një grua burrneshë shtëpie  
Mbesa e Marash Zefit të Kabashit  
Njohtë prej Puke deri në Vaut të Spacit  
Kudo ra iu duke autoriteti  
E vlerësoi vendi e shteti  
Neta burrneshë, me moral të lartë  
Rriti dy djemtë si pëllumba të arte  
Ju dha burrni e shkollim të lartë  
Në Amerike 10 vjet punë  
Për grua e fëmijë kontribuoi  
Kushte normale iu krijoi  
Në mes të lodhjes e trazimit  
Aty i erdh dita e gëzimit  
Mori kartën e qëndrimit  
Në Amerike me u sistemua  
Me grua e fëmijë me u bashkua  
Erdh në Shqipni plote gëzim  
Harroi vuajtje e trazim  
Se kishte letrat për bashkim  
Kjo ardhje ishte si befasi  
Solli gëzim e shumë lumturi  
Për babe e nenë, grua e fëmijë  
Për shoke e miq e vëllezërit e tij  
Pese dite gëzime, që nuk harrohen  
Mjerisht në vite do të kujtohen  
Kur gëzimet ishin si në feste



Në mes të natës pushim tu fjet  
Nata e tmerrit keq la ëmën  
E goditi infarkt në zemër  
I pushkatoi ditët e gëzimit  
Solli lotët e trishtimit  
Nata e zeze e pa mëshirë  
Trishti njerëzit, gruan e fëmijën  
Kjo ndodhi natën e 28-tës  
Ajo i solli fundin e jetës  
Si bombë ra kjo fatkeqësi  
Pikëlloi burra, pleq e të rij  
Kush e njohu emrin e tij  
Shumë populli në kortezi  
“Në jetë pata shumë rastësi  
Po s' kisha pa as dëgjua”  
Gjithë ky popull u bashkua  
Aty te vorret e Rrmajve  
Ishte mbush gjithë ai vend  
Fisi i Shllakut me lule në dorë  
Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, me kunorë  
Me përcjellë ditën e fundit  
Ketë kreshnik burrë tradite  
Ai e mbylli jetën sot  
Po përcillet me vaj e lot  
Pushoftë në paqe te i madhi Zot  
Familjes e gruan me fëmijë  
E të gjithë të afërmeve të tij  
I forcoftë Zoti, në jetë përparësi  
Pushoftë në Paqe!

**Pjeter Gera,**  
nëntor 2022, Bruksel-Belgjike

## E pazakontë! Në këtë qytet të Europës nuk të lejohet as të vdesësh, as të lindësh dhe as të mbash mace

SOT, 3 tetor 2022

Ekziston një qytet në botë ku nuk lejohet as të lindësh, as të vdesësh dhe as të mbash mace!

Bëhet fjalë për Longyearbyen në qendër të Svalbard, në Norvegji, ka ekzistojnë disa ligje shumë të veçanta që ndiqen nga 2.000 banorët e tij.

Ky vendbanim njihet si qyteti më i afërt me Polin Verior, ndaj në periudhën e dimrit nata mund të zgjasë deri në 4 muaj. Përveçse një vend i errët e i ftohtë, ky qytet i vogël nisi të tërheqë shumë turistë, jo vetëm për historinë e tij magjepsëse, por edhe për rëndësinë e tij për të ardhmen e njerëzimit.

Longyearbyen u krijua si një vendbanim për njerëzit që punonin në minierën e qymyrit, e cila në atë kohë ishte një nga minierat më të mëdha të qymyrit në Skandinavi. Në vitet 90-të kur miniera u shterua, punëtorët nuk u larguan, por u vendosën aty duke krijuar këtë qytet të vogël.

Për të gjitha këto arsyeje, banorëve të

kësaj zone iu është dashur të zbatonin disa ligje të ashpra të cilat për të huajt mund të mos kenë kuptim ama për ata, ato janë e vetmja mënyrë që kanë pasur për të mbijetuar

Nuk lejohet as të vdesësh as të lindësh  
Më saktë, nuk lejohet as të vdesësh as të sjellësh dikë në jetë. Dy ligje shumë ekstreme të vendosura nga vetë njerëzit



që jetojnë në Longyearbyen.

Fillimisht, arsyeja pse nuk ju lejohet të vdisni në këtë qytet është sepse aty, nuk mund të varrosni dikë në dëborë pasi trupi do të dekompozohet shumë ngadalë. Kjo do të tërhiqte arinjte polarë që janë një nga rreziqet më të mëdha për banorët e kësaj zone.

Prandaj, në rast se dikush ndihet shumë

i sëmurë deri në pikën kur mund të vdesë, ai është i detyruar të dërgohet në anën jugore të Norvegjisë për t'iu dhënë mjekimi i duhur ku në rastin më të keq, mund edhe të varrosen.

Ligji i dytë i ndalimit të lindjes në këtë vendbanim vjen për një arsye më të thjeshtë. Dhe ajo është sepse ky vendbanim nuk ka një maternitet për shkak të numrit të vogël të banorëve.

Ndaj, për të shmangur çdo rrezik gjatë lindjes, gratë shtatzënë janë të detyruara të shkojnë në qytetin më të afërt i cili ka një maternitet. Edhe një herë, për të shmangur çdo vdekje të panevojshme.

Një ligj tjetër interesant është se as macet nuk lejohen në këtë vendbanim

Kjo për shkak se macet mund të gjuajnë zogjtë që jetojnë apo vërtiten në këtë qytet duke bërë që ata të zhduken. Pra, në vend që të marrin një rrezik të panevojshëm, ata e shmangin atë.

Të jetosh në një vend kaq ekstrem, duhet të shmangësh çdo lloj rreziku të mundshëm nëse dëshiron të mbijetosh.

# Lula Bregu (Prroni)



*Lindur ne Brashte -Shosh, mbaruar shkollën e Larte, Universiteti "Luigj Gurakuqi, dega Gjuhe-Letërsi Mësuese në Torovicë-Lezhë.*

## MALL VENDLINJE

Fshati im i bukur atje ne malësi  
veç qiellin me re më paska kufi.  
Pyje, ara, lisa të pastra flori,  
pat rrit djem të pashëm e vajza shtatselvi.

Eh... dikur i mbushur plot me gaz e shend,  
U rritem në bjeshkë, si lulja në gem.  
Shëndetin argjend, faqet kuq si molla,  
e donim natyrën, na pëlqente shkolla.

Vendi im i bukur të kujtoj me mall,  
mrekulli e botës, kohë ka që s'kam ardhë.  
Ikëm fort larg teje, për një jetë më të mirë...  
Të kthehem te Ti gjithmonë kam dëshirë.

E tash nëpër ëndrra fluturoj te Ti,  
mrekullia jote më mbush me qetësi.  
Parajsja e kësaj bote ju vendet e mia,  
mall e nostalgji ku m' shkoi fëmijëria

Ndiej mall e dëshirë, por kam edhe frikë  
Të ndaloj te pragu ku zjarri u fik...  
Ku e ndjera gjyshe na mblidhte në trevëz,  
E di...nuk do gjej as vëlla ...as motër...

Të gjithë ikën larg e ty të lanë shkretë  
Loti ynë i mallit nëpër botë u tret.  
Kullat mbyllën dyert, fëmijë shkolla s'ka,  
për varret e të parëve malli na ka tha...

Kam frikë se shtëpia mu paska rrënuar  
kam frikë se komshia më qenka larguar...  
Kam frikë s'do e gjej ma shoqen e fëmijërisë,  
druaj se janë tharë dhe degët e qershisë...

Kjo qershia ime që mbart një kujtim,  
loti që me lidh me vëllain tim.  
Druaj t'i afrohem se ka mbetur shkretë,  
Ndoshta ajo tharë...vëllai diku tret...

Dikur mbi një gur emrin pata gdhend,  
veç vdekja me ndan thosha nga ky vend.  
E tash edhe rruga nuk po duket ma...  
E ku ta gjej gurin që emrin tim mban...???

Nuk me vjen në mendje aspak sa kam vuajt,  
kur kujtoj shoqërinë, që me ta kam luajt.  
Me mall kujtoj shkollën që m' pat pritë gjithmonë.  
Mall dhe për mësuesin që sot nuk jeton...

Sa kujtime kam te Ti fshati im,  
kurrë rrugët e botës s'kanë si Ti ndriçim.  
Njerëzit më të shtrenjtë që i ka kjo botë,  
te Ti përgjithmonë i kujtoj me lot....

Vendi im i shtrenjte të kujtoj me mall,  
mall që nuk do shuhet sa të jemi gjallë.  
mall për çdo ditë ku shkoi fëmijëria.  
Zoti i bekoftë këto trojet e mia!

Kushtuar fshatit tim të lindjes  
Brashtë-Shosh-Dukagjin -Shkodër.

## MALL KURBETI

Ah kurbet ti qofsh mallkua!  
Na ke nda, na ke copitua  
Nanë e babë me i lanë në shpi  
Në kurbet nusja me fëmijë...

Herë po shkon e herë po vjen.  
Kund qetësi shpirti s'po gjen.  
Po na plas ky mall i shkretë  
Mall e lot, me u mbush një det...

Aspak vlere jeta s'po ka  
Nanë e babë kur rrinë pa i pa.  
Hiç s'ka vlerë kjo pasuri  
Kur rrinë zemra gri e shkri.

Politike, ti moj dalsh fare!  
Për së gjalli zemrat na i thave.  
Se na i mori fëmijën kurbeti.  
S'po iu ngop toka as deti...

Krejt Shqipërinë lanë ua kanë,  
Toke e det me ujë e ranë ...  
Këtu e lanë gjithë pasurinë,  
Dhimbjen morën e një çantë mbi shpinë...

Këtu lanë shumë copëza jete...  
Lanë këtu dhe një pjesë zemre...  
Pres me shprese me ardh një dite ...  
Mos me u djeg mallit ky shpirt...

Larg prej gjakut e prej fisit,  
Po i rrisim bimët e shpirtit.  
Nanë e babë pa i pa me vjet,  
Qofsh bekua moj jetë e shkretë!

## MËRGIMTARI IKU PRAPË

Mërgimtari erdh' një ditë,  
me mall t' zemrës e kam pritë.  
Djeg ju pat zemra n' kurbet  
ardh nuk pat tash disa vjet...

Dhurata krejt na pat ba,  
nanë e babë motër e vëlla.  
Nip e mbesë e vëlla e motër  
na bashkoi t' gjithëve një trevëz.

Njëherë motër e njëherë vëlla  
përditë vinte me na pa.  
Qanim hallet një nga një...  
shume kujtime e nostalgji.

Shumë kujtime gjate e gjanë,  
natën zgjuar mbi divan.  
Kur qante hallet e veta,  
vuajtjet që i shkaktoi jeta .

Sa shumë halle që s'i dita...  
sa shumë derte e lot që s' prita.  
Se kurbeti s' ka mirësi ...  
s' qenka jeta pasuri...

Malli m' merr për troje t' mia  
asgjë s' vret thotë sa vetmia.  
Se jetojmë në botën e madhe,  
gjithkush ka të vetat halle.

Shpejt e shpejt ditët kaluan,  
ikën, pushimet mbaruan.  
I numëruam e dolën pak,  
mërgimtari iku prapë.

Kaloi male e kaloi dete,  
mall e dhimbje mor' me vete.  
E la zemrën në shtëpi,  
te prindërit ne pleqëri.

Këtu e la për babë e nanë,  
për motrën e për vëllanë.  
E la këtu për farefis,  
për shoqërinë e fëmijërisë.

Mërgimtar ti ike shkove,  
përveç mallit gjë nuk more.  
Sy për lotur dole nga shpija,  
mall që din ta ketë veç bija.

Një dhuratë thashë që s'ta bana,  
atje the i kam të tana.  
Veç bekim deshe me t' dhanë,  
prapë me i gjete këtu babë e nanë.

Prapë me ardh e me festua,  
prapë me u pa e prapë me u gëzua.  
Se atje ne dhe të huaj...  
kurrë se zë kush vendin tuaj.



## REDAKSIA

Kryeredaktore: LUIGJ SHYTI

Prelë Milani, Lazer Stani, Roza Pjetri, Lazer Kodra, Zef Nika,  
Zef Gjeta, Lulash Brigja, Age Martini, Klodjana Serraj, Vilsan  
Peshkaj, Marjan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon  
Fierza, Ndue Ziçi, Gazper Marku, Mark Gjeka.

Mundësoi botimin:

**KRYESIA E SHOQATËS ATDHETARE  
"DUKAGJINI"**